



Studimet pasdiplomike-cikli i dytë

Teza:

“Studim krahasimor mbi përdorshmërinë, benefitet dhe llojet e platformave të MOOC në botë dhe në rajon”

Mentor:

Prof. Dr. Lejla Abazi-Bexheti

Kandidati:

Almedin Agushi

Tetovë, 2021

Deklaratë

Deklaroj se kjo tezë dhe puna e raportuar këtu, ka përbërje tërësisht origjinale. Informacioni i marrë nga puna e botuar ose e pabotuar, e të tjerëve është e cituar në tekst dhe referencat janë dhënë në listën e burimeve.

Декларацијата на оригиналност

Изјавувам дека оваа теза и работите пријавени во овој документ потекнува и е составен целосно од мене. Информациите добиени од објавени и необјавени работи на другите се признаени во текстот и препораките се дадени во листата на извори.

Declaration of Originality

I hereby declare that this thesis and the work reported herein, was composed by and originated entirely from me. Information derived from the published and unpublished work of others has been acknowledged in the text and references, are given in the list of sources.

Almedin Agushi

Falënderim

Së pari do të falënderoj mentoren time, Prof. Dr. Lejla Abazi-Bexheti, për udhëzimet dhe mbështetjen gjatë gjithë procesit të hulumtimit dhe përpilimit të kësaj teze të magjistraturës. E falënderoj që më kushtoi aq shumë kohë dhe vëmendje kur kisha nevojë për udhëzime, mbështetje, këshilla. Për gjatë kësaj rruge sfiduese, ajo ishte një burim frymëzimi për punën time. Për të arritur synimet tona, sidomos kur puna jonë është një rrugë e gjatë me plot sfida dhe kërkesa të ndryshme, ajo çka nevojitet është të kemi mbështetje dhe përkrahje nga të tjerët. Për fatin tim të mirë, unë mora shumë mbështetje nga të tjerët gjatë tërë periudhës së realizimit të këtij punimi.

Dhe një falënderim i veçantë shkon për të gjithë shokët, kolegët dhe miqtë e mi, të cilët gjatë tërë kohës më kanë mbështetur dhe përkrahur në punën time. Falënderoj bashkëshorten time, prindërit e mi për mbështetjen dhe inkurajimin e tyre të vazhdueshëm. Përkrahja e tyre gjatë studimeve, ashtu edhe gjatë përpilimit të kësaj teme, bëri të mundshëm realizimin e qëllimit tim.

Faleminderit të gjithëve!

Përmbajtja

ABSTRAKT	6
АБСТРАКТ	7
ABSTRACT	8
LISTA E FIGURAVE	9
LISTA E TABELAVE	9
KAPITULLI 1 – HYRJE NË STUDIM	11
1.1. Korniza konceptuale – Lënda e hulumtimit	13
1.2. Qëllimet e studimit	16
1.3. Hipotezat.....	16
1.4. Pyetjet kërkimore.....	17
1.5. Metodologjia e hulumtimit.....	17
1.6. Mostra dhe mbledhja e të dhënave.....	19
1.7. Arsyeshmëria e studimit	19
KAPITULLI 2 – KONCEPTI I MOOC-ave.....	20
2.1. Përkufizimi i konceptit MOOC dhe origjina e tij.....	20
2.2. Dizajnimi apo modelimi i MOOC dhe rëndësia e tyre.....	27
2.3. Dimensionet dhe ideologjia e MOOC-ave.....	31
KAPITULLI 3 – SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	35
3.1. Përdorimi i MOOC në arsim dhe efektet e tij	35
3.2. Përparësitë dhe mangësitë e MOOC-ave.....	38
3.3. Trendi i përdorimit të MOOC në botë dhe rajon	43
KAPITULLI 4 – ANALIZA DHE INTERPRETIMI I TË DHËNAVE NGA HULUMTIMI.....	54
4.1. MOOC-at dhe përdorimi i tyre në edukim	54
4.1.1. Demografia e pyetësorit	54
4.1.2. Sa janë të njohur të anketuarit me MOOC-at.....	56
4.1.3. Vlerësimi i MOOC-ave	56
4.1.4. MOOC-at dhe mundësia për mësim gjatë gjithë jetës.....	57
4.1.5. MOOC-at përdoren për arsimim joformal	57
4.1.6. Përvoja në përdorimin e MOOC-ave.....	58
4.2. Gjuha dhe MOOC-at.....	58
4.2.1. Përpunim i titrave të lëndës Python në Udacity.....	61
4.2.2. Demografia e pyetësorit për tutorialet në Python nga Udacity.....	62

4.2.3. Sa kanë dëshirë të anketuarit të mësojnë mësimet apo kurset përmes videove	63
4.2.4. Tutorialet online a janë të përshtatshme për mësim joformal sesa formal	64
4.2.5. Cila është mënyra më e mirë e të mësuarit.....	64
4.2.6. Mënyra më e mirë e të mësuarit është përmes kurseve online.....	65
4.2.7. Kursi online me përkthim në gjuhën tuaj amtare është më i përshtatshëm.....	65
4.2.8. Mënyra më e mirë e të mësuarit është face to face.....	66
4.2.9. A ndihmojnë tutorialet me titra të përkthyer në gjuhën shqipe në përvetësimin e temës së prezantuar	66
KAPITULLI 5 – REZULTATET E STUDIMIT	67
5.1. Cilat janë llojet e MOOC që përdoren në rajonin tonë?	67
5.2. Kush janë përdoruesit e MOOC dhe kush përfiton nga MOOC?	68
5.3. A e rrit MOOC interesimin dhe mundësinë për arsim gjatë gjithë jetës?.....	70
5.4. Cila është mënyra më efikase e përdorimit të MOOC?	70
5.5. Çfarë ndikon në përvetësimin e përmbajtjeve gjatë ndjekjes së ligjëratave në MOOC?	71
5.6. Cili është perceptimi i palëve të interesit për MOOC?	71
5.7. Analiza e hipotezave	72
5.7.1. Hipoteza 1	72
5.7.2. Hipoteza 2	72
5.7.3. Hipoteza 3	73
6. KONKLUDIMI	74
6.1. Kontributi i punimit.....	74
6.2. Kufizimet e punimit.....	74
6.2. Rekomandimet.....	74
BIBLIOGRAFIA.....	76
SHTOJCAT	85
Pyetësi 1: MOOC-at dhe përdorimi i tyre në edukim	85
Pyetësi 2: Përpunim i titrave të lëndës Python në Udacity	85

ABSTRAKT

Teknologjia moderne digjitale luan një rol të rëndësishëm në sistemin e arsimit sipëror. Zbatimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në arsimin sipëror tashmë është një domosdoshmëri dhe po tregon sukses në zhvillimin e procesit mësimor. Zhvillimi i teknologjisë dhe përdorimi i gjerë i materialeve digjitale kanë sjellë ndryshime drastike në çdo aspekt të jetës së përditshme dhe kjo gjë normalisht ka ndikuar edhe në fushën e mësimin nga distanca apo online. Në këtë drejtim, MOOC (Massive Open Online Courses) "Kurset masive të hapura në internet" si një platformë që ofron 'kurse masive të hapura online' e që është i bazuar në internet po synon të sigurojë një format arsimor gjithëpërfshirës dhe krejt ndryshe nga formatet e mëparshme të arsimit sipëror. MOOC ka ushtruar një ndikim të rëndësishëm në arsimin sipëror, por jo vetëm, duke mundësuar një gamë të gjerë të kurseve të hapura masive online për pjesëmarrje të një numri të madh të studentëve dhe profesionistëve nga lëmi të ndryshme të jetës profesionale të shpërndarë gjeografikisht në gjithë rruzullin tokësor e që duan të mësojnë nga distanca nëpërmjet internetit në universitetet më prestigjioze botërore, siç janë Harvard, Cambridge, MIT, Yale, Stanford, etj. Prandaj, kjo tezë e magjistraturës do të nxjerrë në pah llojet e ndryshme të platformave dhe organizatave që ofrojnë MOOC si dhe efektin që MOOC ka në arsimin a lartë si dhe në lëmi të tjera. Po ashtu, do të përpiqemi që nëpërmjet kësaj teze të magjistraturës të pasqyrojmë trendin aktual të ofertave të shumta të kurseve të hapura masive online (MOOC) si dhe përparësitë dhe mangësitë e MOOC. Njëherit, do të mundohemi të nxjerrim në pah sfidat e ndryshme me të cilat ballafaqohet arsimi i lartë kundrejt MOOC. Po ashtu, do të bëjmë përpjekje të nxjerrim në pah përputhjet eventuale të arsimit tradicional apo edhe të atij në distancë me atë të ofruar nëpërmjet MOOC dhe të vlerësojmë nëse MOOC mund të rrezikojë funksionimin normal të universiteteve apo të ndihmojë ato në misionin e tyre. Ky studim përdori metoda hulumtuese përshkruese, krahasimore dhe analitike. Po ashtu, metoda hulumtuese sasiore u përdor për të mbledhur të dhënat e nevojshme dhe për të analizuar përmbajtjen dhe efektet e MOOC në arsimin e lartë, ndërsa metodat hulumtuese kuantitative u përdorën për të analizuar perceptcionet e palëve të interesit për përdorimin e MOOC.

АБСТРАКТ

Современата дигитална технологија игра важна улога во системот на високото образование. Примената на информатичката и комуникациската технологија во високото образование е веќе неопходност и покажува успех во развојот на наставниот процес. Развојот на технологијата и широко распространетата употреба на дигитални материјали донесоа драстични промени во секој аспект од секојдневниот живот и тоа нормално влијаеше и на полето на учење од далечина или преку Интернет. Во врска со ова, МООС како платформа што нуди „масивни отворени курсеви преку интернет“ и се базира на Интернет, има за цел да обезбеди сеопфатен образовен формат и доста различен од претходните формати на високото образование. МООС изврши значително влијание врз високото образование, овозможувајќи широк спектар на масовни отворени курсеви преку Интернет за учество на голем број студенти и професионалци од различни сфери на животот географски распространети низ целиот свет кои сакаат да студираат од далечина преку Интернет на најпрестижните универзитети во светот како Харвард, Кембриџ, МИТ, Јеил, Стенфорд итн. Затоа, оваа магистерска теза ќе ги потенцира различните видови платформи и организации кои нудат МООС, како и ефектот што МООС го има врз високото образование, како и во другите области. Исто така, ќе се обидеме преку оваа магистерска теза да го одразиме моменталниот тренд на бројни понуди за отворени масовни курсеви преку интернет (МООС), како и предностите и недостатоците на МООС. Воедно, ќе се обидеме да ги потенцираме различните предизвици со кои се соочува високото образование наспроти МООС. Исто така, ќе се обидеме да ги потенцираме можните совпаѓања на традиционалното или дури и далечинско образование со понуденото преку МООС и да процениме дали МООС може да го загрози нормалното функционирање на универзитетите или да им помогне во нивната мисија. Оваа студија користи описни, компаративни и аналитички методи на истражување. Исто така, методот на квантитативно истражување беше искористен за да се соберат потребните податоци и да се анализираат содржината и ефектите на МООС во високото образование, додека квантитативните методи на истражување беа користени за да се анализираат перцепциите на засегнатите страни за користење на МООС.

ABSTRACT

Modern digital technology plays an important role in the higher education system. The application of information and communication technology in higher education is already a necessity and is showing success in the development of the learning process. The development of technology and the widespread use of digital materials have brought about drastic changes in every aspect of daily life and this has normally also affected the field of distance or online learning. In this regard, MOOC as a platform that offers 'massive open online courses' which is based on the Internet is aiming to provide a comprehensive educational format and is quite different from previous formats of higher education. MOOC has exerted a significant impact on higher education but not only by enabling a wide range of massive open online courses for the participation of a large number of students and professionals from different walks of life geographically spread across the globe who want to study remotely via the Internet at the world's most prestigious universities such as Harvard, Cambridge, MIT, Yale, Stanford, etc. Therefore, this master thesis will highlight the different types of platforms and organizations that offer MOOC as well as the effect that MOOC has on higher education as well as in other areas. Also, we will try through this master thesis to reflect the current trend of numerous offers of 'massive open online courses' (MOOC) as well as the advantages and disadvantages of MOOC. We will also try to highlight the various challenges facing higher education versus MOOC. We will also try to highlight the possible matches of traditional or even distance education with that offered through the MOOC and assess whether the MOOC may jeopardize the normal functioning of universities or assist them in their mission. This study used descriptive, comparative and analytical research methods. Also, quantitative research methodology was used to collect the necessary data and analyze the content and effects of MOOC in higher education, while quantitative research methods were used to analyze stakeholder perceptions of using MOOC.

LISTA E FIGURAVE

Tabela 1. Ofruesit kryesorë të MOOC për sa i përket përdoruesve dhe ofertave	44
Tabela 2. Programet studimore online	44
Tabela 3. Microkredencialet	45

LISTA E TABELAVE

Grafiku 1. Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë.....	54
Grafiku 2. Shpërndarja e të anketuarve sipas moshës	55
Grafiku 3. Shpërndarja e të anketuarve sipas vendlindjes të studentëve	55
Grafiku 4. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “A keni dëgjuar për MOOC-at?”	56
Grafiku 5. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “Nëse keni dëgjuar, si do t’i vlerësoni MOOCs-at?”	56
Grafiku 6. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “A e risin MOOC mundësinë dhe interesimin për arsimim gjatë gjithë jetës? (life long learning)”	57
Grafiku 7. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “ MOOC-at përdoren për arsimim joformal!”	57
Grafiku 8. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “ A keni ndjekur ndonjë MOOC?”	58
Grafiku 9. Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë.....	62
Grafiku 10. Shpërndarja e të anketuarve sipas moshës	62
Grafiku 11. Shpërndarja e të anketuarve sipas vendlindjes të studentëve	63
Grafiku 12. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “A dëshironi të mësoni mësimet përmes videove?”	63
Grafiku 13. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “Tutrialet Online janë më të përshtatshme për mësim joformal sesa për mësim formal?”	64
Grafiku 14. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “Sipas jush, mënyra më e lehtë e të mësuarit është?”	64
Grafiku 15. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “Mënyra më e përshtatshme e të mësuarit është përmes mësimi (Kurseve Online)”	65
Grafiku 16. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “Mësimi (Kurset Online) me përkthim të përshtatur në gjuhën tuaj amtare është shumë më i kuptueshëm”	65

Grafiku 17. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: "Mënyra më e përshtatshme e të mësuarit është face to face?"	66
Grafiku 18. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: "Tutortialet me titra të përkthyer në gjuhën shqipe ndihmojnë shumë në përvetësimin e temës së prezantuar."	66

KAPITULLI 1 – HYRJE NË STUDIM

Qëllimi primar i misionit të arsimit përqendrohet në përcjelljen e dijes dhe aftësive midis gjeneratave, gjithnjë me parashikim që gjenerata e re të marrë përgjegjësi të vazhdueshme në avancimin e mirëqenies njerëzore drejt integritit të vlerave të shoqërisë konkurrense të dijes. Andaj, qëllimi i arsimit sot fokusohet pikërisht në aftësimin e njeriut që të menaxhojë me forcën e shkencës për ta përmirësuar jetën. Kjo nënkupton zhvillimin e mendjes si parakusht të domosdoshëm për pragmatizimin e shkencës. Në këtë drejtim shumë dijetarë kanë kërkuar mënyra të ndryshme që gjeneratave të reja t'u mundësohet një qasje sa më e lehtë në arsimim.

Nga ana tjetër, për një kohë të gjatë sistemi arsimor është kritikuar për mungesë teknikash efektive të të mësuarit ose të mësuarit të bazuar në aftësi. Prandaj, kohën e fundit teknologjia po bën ndryshim të madh në zhvillimin e arsimit si dhe në përvetësimin e dijeve të reja nëpërmjet teknologjisë. Teknologjia është bërë pjesë e pashmangshme e arsimit. Arsimi i bazuar në teknologji duket një hap drejt revolucionarizimit të arsimit. Teknologjia dhe arsimi janë një kombinim i shkëlqyeshëm nëse përdoren së bashku me një arsye dhe vizion të duhur. Viteve të fundit, teknologjia mbështet arsimin njëzet e katër orë në ditë dhe ndihmon njerëzit të ndërtojnë aftësi të shekullit të njëzet e një. Teknologjia po zgjeron ofertat e kurseve dhe materialet mësimore nëpërmjet internetit. Teknologjia u jep studentëve qasje të menjëhershme në informacion të bollshëm dhe cilësor, i cili ndikon në përshtetshmërinë e ritmit të të mësuarit.

Arsimi nëpërmjet internetit duke përdorur teknologjitë më të avancuara tani është i akredituar dhe ka ndryshuar mënyrën e arsimimit. Studentë, nxënës por edhe profesionistë të ndryshëm mund të marrin kurse online për qëllime të ndryshme si arsimore po ashtu edhe për përparim në karrierë. Teknologjia në arsim po i përgatit studentët për të ardhmen ose më saktë 'gjeneratën e ardhshme' dhe përderisa teknologjia po përmirësohet në vazhdimësi programet në internet po bëhen më tërheqëse. Ekspertët e arsimit parashikojnë

që arsimi në distancë, gjegjësisht arsimi nëpërmjet internetit dhe pajisjeve të avancuara teknologjike do të vazhdojë të zgjerohet dhe të bëhet më kompleks në të ardhmen.¹

Kurset online të krijuara me anë të regjistrimeve të videove paraprakisht nga ana e mësimdhënësve u bë një praktikë e re e arsimimit nëpërmjet internetit e ofruar nga organizata të ndryshme siç janë Coursera, Udacity dhe EDX, etj. Në këto kurse studentët shikojnë video ligjërata të mësimdhënësve të regjistruara paraprakisht dhe krijojnë komunitete të zgjeruara në klasë për diskutime ose klasa virtuale etj. Sot vlerësohet se 1 në 4 studentëve universitarë janë regjistruar në të paktën një kurs apo lëndë në internet. Në vitin 2009 kishte mbi 4.5 milionë studentë që ndiqnin ligjërata në internet.²

Pra, interneti mundësoi oferta masive të kurseve online. Arsimimi dhe zhvillimi profesional në internet gjithashtu ka nxitur ndryshime të rëndësishme edhe në universitete tradicionale. Tani pothuajse të gjitha universitetet po ofrojnë studime dhe kurse specifike online. Një numër në rritje i universiteteve, si Universiteti i Kalifornisë në Berkeley, Universiteti i Harvardit dhe Instituti i Teknologjisë i Masaçusetsit ofrojnë kurse falas në internet të quajtura kurse të hapura që përmbajnë leksione video dhe kuize të marra direkt nga ligjëratat në klasë.

Hulumtimi mbi Kurset Masive të Hapura Online (MOOC) është të paktën po aq i vjetër sa prezantimi i MOOC të parë. MOOC dhe analitika e të mësuarit u dhanë studiuesve një mundësi unike për të ndjekur studentët nga afër në mënyrën e tyre të të mësuarit. Kjo gjeneroi gjetje të reja mbi mënyrën e të mësuarit të studentëve, zhvilloi më tej njohuritë mbi teknologjinë e të mësuarit, ndërsa për mësimdhënësit nxori rekomandime dhe udhëzime që mësimdhënësit të nxjerrin maksimumin nga kurset e tyre.

Kurset e hapura masive online (MOOC) që nga viti 2011 reflektojnë prirje të konsiderueshme të zhvillimit të arsimit në distancë. Për herë të parë u prezantuan nga disa organizata si Coursera, Udacity dhe EDX. Kjo përpjekje u pasua nga një përgjigje e shpejtë nga universitetet ndaj konceptit dhe praktikës së të mësuarit në internet në të cilën janë bashkuar miliona studentë, nxënës dhe profesionistë në një bazë globale. MOOC mbulojnë shumë fusha shkencore duke përfshirë shkencat humane, mjekësinë, biologjinë, shkencat

¹<https://www.onlineschools.org/visual-academy/the-history-of-online-schooling/>

²<https://www.aplustopper.com/use-of-technology-in-education-essay/>

shoqërore, matematikën, biznesin, shkencën kompjuterike. Studentët mund të marrin pjesë pa pasur nevojë të paguajnë shkollim ose tarifa të tjera të shkollimit ose të ndërpresin studimin e ndonjë lënde të caktuar dhe më pas të ristartojnë përsëri.

Shumë njerëz filluan të spekulojnë nëse MOOC do të prishin arsimin e lartë, duke pasur parasysh kurset në MOOC mund të gjinden edhe falas përfshirë këtu edhe certifikatat, ndërsa studimet në universitete kushtojnë shumë para.

Sidoqoftë, kurset Masive të Hapura Online, ose MOOC, po bëhen realiteti i kohës më të re dhe po ndryshojnë mënyrën e të mësuarit në internet. MOOC mundëson qasjen e një numri të madh të punësuarish në institucione të ndryshme si arsimore po ashtu edhe biznesi të mësojnë në internet me ritmin e tyre, pra duke riprogramuar vazhdimin e të mësuarit në MOOC.

Duke pasur parasysh gjithë atë që përmendëm më sipër, ne do të përpiqemi që nëpërmjet kësaj teze të magjistraturës të nxjerrim në pah llojet e ndryshme të platformave të MOOC, historikun e tyre, trendin aktual të ofertave të shumta të kurseve të hapura masive online, ndikimin e tyre në arsim dhe biznes, në veçanti në arsimin sipëror si dhe përparësitë dhe mangësitë e MOOC. Po ashtu, do të mundohemi të nxjerrim në pah sfidat e ndryshme me të cilat ballafaqohet MOOC që jo domosdoshmërisht mund të provojnë të jenë pengesa për zbatimin e tij. Po ashtu do të bëjmë përpjekje të nxjerrim në pah ndeshjet eventuale të arsimit tradicional me atë të ofruar nëpërmjet kurseve të hapura masive online dhe të vlerësojmë nëse MOOC mund të rrezikojë funksionimin normal të universiteteve apo të ndihmojë atë në misionin e tyre.

1.1. Korniza konceptuale – Lënda e hulumtimit

Lëndë e këtij hulumtimi apo më saktë e kësaj teze të magjistraturës është MOOC (Massive Open Online Courses) që paraqet një risi në mësimin në distancë, formati i të cilëve dallon nga formati klasik i mësimdhënies dhe nxënies nëpërmjet internetit gjegjësisht nga distanca gjatë së cilit mësimdhënësit ligjëratat e tyre i zhvillojnë në mënyrë interaktive me studentët e tyre. Por, duhet theksuar se MOOC dukshëm dallon nga arsimi tradicional, pra i atij në klasë, apo i atij që zbatohet online nëpërmjet platformave për mësim në

distancë apo të atyre siç janë Google Meet apo Zoom, pasi i tërë procesi arsimor në MOOC zhvillohet online pa prezencë fizike të mësimeve të mësimdhënësve që ligjërojnë ato kurse dhe pa interaktivitet.

Përveç kësaj, lëndë tjetër e kësaj teze të magistraturës është edhe ndryshimi që MOOC ka shkaktuar në mënyrën se si u mundësohet një numri të madh të të interesuarve për t'u arsimuar pa ndjekur ligjërata në klasë fizikisht, pra nga shtëpitë e tyre pa shpenzime rruge apo të qëndruari në banesa me qira apo konvikte të universiteteve.

Më tej, lëndë e kësaj teze të magistraturës është edhe ndikimi që ka MOOC në arsimin sipëror.

Mësimi nëpërmjet internetit duke përdorur teknologjinë më të avancuar paraqet nevojën e kohës bashkëkohore dhe praktikën e kësaj mënyre të të mësuarit kërkojnë një qasje krejt ndryshe nga ajo tradicionale apo edhe të asaj të bazuar në teknologjinë informative në klasë (TIK). Prandaj, për t'u përshtatur me këtë praktikë të re të mësimeve dhe nxënies duhet të rridefinohen edhe praktikën edukative arsimore duke inkorporuar kurse masive të hapura online në ofertat e tyre programore.

Më tej, përdorimi i pajisjeve teknologjike po bëhet pjesë e rëndësishme e procesit të mësimeve dhe nxënies si brenda institucioneve arsimore, po ashtu edhe jashtë atyre. Përdorimi i teknologjisë më të avancuar në mësim po bëhet me qëllim të përmirësimit të praktikave të mësimeve dhe nxënies. Kjo mënyrë ka për qëllim ofrimin e mundësive më të përshtatshme për ata që janë të interesuar të ndjekin mësim online, në vend që të ndjekin studime në universitete, gjegjësisht për studentë të gjeneratës së re që njihen edhe me termin 'gjenerata Z', që përdorimin e pajisjeve të ndryshme teknologjike e kanë përditshmëri dhe aparaturat e ndryshme teknologjike u janë bërë pjesë e jetës së tyre të përditshme.

Kurset Masive të Hapura Online (MOOC - "Massive Open Online Courses") janë në zgjerim e sipër kohëve të fundit në arsimin e lartë që përjetoi zhvillim të shpejtë dhe arriti vëmendje të konsiderueshme nga një gamë e gjerë e studentëve, nxënësve dhe të të punësuarve në institucione të ndryshme arsimore dhe të biznesit. Kurset konsistojnë në leksione video të para-regjistruara, teste të vlerësuara me nota dhe përqindje në kompjuter dhe forume diskutimesh për të shqyrtuar materialet e kursit ose për të kërkuar ndihmë

(Hoy, 2014). MOOC ofrojnë arsim me cilësi të lartë nga universitetet më të mira të botës, zakonisht falas. Këto universitete ofrojnë kurset e tyre përmes ofruesve kryesorë të MOOC siç janë Coursera³, edX⁴, Udacity⁵ dhe Udemy⁶.

Hapja në arsim ka evoluar me kalimin e kohës dhe ka dalë në forma të ndryshme (Weller, 2014). Sugjerohet që “ekzistojnë tri fenomene kyçe që çojnë në grupin e tanishëm të koncepteve themelore të arsimit të hapur: arsimim të hapur, softuer me kod të hapur dhe web 2.0”. Sigurimi i qasjes në mundësitë më të larta të të nxëniet është arsyeja e ofrimit të kurseve online të universiteteve të hapura (Tait, 2008). MOOC janë një zhvillim i kohëve të fundit të cilat kanë tërhequr shumë vëmendjen e sferës akademike dhe të biznesit. Kursi i parë në këtë format u ofrua në vitin 2008 në Universitetin e Manitobas dhe kishte të drejtën e Lidhjes dhe Njohuri Lidhëse (Liyanagunawardena, Adams, & Williams, 2013).

MOOC nuk janë një fenomen i pavarur, i izoluar nga zhvillimet e tjera në fushën e mësimin të hapur dhe të distancës ose të teknologjisë arsimore. Përkundrazi, MOOC janë të lidhura fort me zhvillimet e tjera në këtë fushë, duke pasur potencial për të mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të eliminuar barrierat në procesin e të mësuarit, për të siguruar barazi në arsim dhe, më e rëndësishmja, për të siguruar liberalizimin e njohurive.

MOOC janë një fushë e re që janë në zhvillim e sipër. Numri i studiuesve të MOOC kohëve të fundit është rritur jashtëzakonisht shumë. Me siguri, se studiuesit do të vazhdojnë të përcjellin zhvillimin e MOOC pasi MOOC mund të revolucionarizojnë arsimin e lartë në

³ Coursera Inc. është një ofrues masiv amerikan i MOOC i themeluar në vitin 2012 nga profesorët e shkencave kompjuterike të Universitetit të Stanfordit Andrew Ng dhe Daphne Koller. Coursera punon me universitete dhe organizata të tjera për të ofruar kurse në internet, certifikime dhe diploma në një larmi temash. Sipas CNBC "më shumë se 150 universitete ofruan më shumë se 4,000 kurse përmes Coursera, e cila përmban mbi dy duzina programe diplomash me çmime që janë më të ulëta se shumë oferta shkollore personalisht. <https://en.wikipedia.org/wiki/Coursera>

⁴ EdX është një organizatë që u themelua nga një partneritet midis Universitetit të Harvardit dhe Institutit të Teknologjisë të Masaçusetsit (MIT) në 2012. Misioni i edX është që: “të rrisë qasjen në arsim me cilësi të lartë për të gjithë, kudo dhe të përmirësojë mësimdhënien dhe të mësuarit në kampuse dhe në internet; dhe të avancojë mësimdhënien dhe të mësuarit përmes hulumtimit.” (edX | Rreth) Platforma edX dhe sistemi i menaxhimit të të mësuarit është i organizuar si një ndërmarrje jofitimprurëse. (MOOC | Wikipedia) (MOOCs | NYT2012) <https://medium.com/massart-innovation/edx-mooc-with-a-mission-and-a-profit-motive-8d19db93005b>

⁵ Udacity, Inc. është një organizatë arsimore fitimprurëse amerikane e themeluar nga Sebastian Thrun, David Stavens dhe Mike Sokolsky që ofron kurse masivisht të hapura në internet (MOOC). Sipas Thrun, origjina e emrit Udacity vjen nga dëshira e ndërmarrjes për të qenë "e guximshme për studentin". Ndërsa fillimisht u përqendrua në ofrimin e kurseve të stilit universitar, tani përqendrohet më shumë në kurse profesionale për profesionistët. <https://en.wikipedia.org/wiki/Udacity>

⁶ Udemy, Inc. është një ofrues i MOOC Amerikan që synon të rriturit profesionistë dhe studentët. Ajo u themelua në maj 2010 nga Eren Bali, Gagan Biyani dhe Oktay Caglar. Studentët regjistrohen në kurset e hapura online të UDEMZ për të përmirësuar aftësitë e nevojshme në profesione të ndryshme. <https://en.wikipedia.org/wiki/Udemy>

kontekst të cilësisë por edhe të globalizojnë arsimin e lartë duke koncentruar interesimin e studentëve në universitetet më të mira në botë dhe duke shmangur universitetet jocalësore.

1.2. Qëllimet e studimit

Në dritën e këtij zhvillimi dinamik, qëllimi kryesor i këtij studimi është të hulumtojë dhe të ofrojë një pasqyrë më të qartë të platformave online MOOC në rajon dhe botë dhe ndikimin e MOOC në arsimin e lartë.

Qëllim tjetër i këtij studimi është të nxjerrë në pah rëndësinë që ka sot interneti dhe pajisjet teknologjike në zhvillimin dhe përmirësimin e arsimit në përgjithësi, si dhe arsimit sipëror në veçanti.

Paralelisht do të nxirret në pah edhe roli i institucioneve arsimore, në veçanti universiteteve në përshtatjen e ofertës me kurse masive online sipas modeleve të MOOC dhe organizatave të ngjashme si Coursera, Udacity dhe edX apo përdorimi i MOOC për zhvillim profesional të të punësuarve si në arsim po ashtu edhe në sferën e biznesit.

Më tutje, qëllimi i kësaj teze magjistrature është edhe studimi i perceptimit të aktorëve të ndryshëm në arsimin online, profesorëve dhe studentëve në lidhje me rolin e MOOC dhe mendimin e tyre për rëndësinë që MOOC ka për arsimimin cilësor të gjeneratave të reja që deri vonë kanë ëndërruar të mësojnë në universitetet më të mira në botë, siç janë Harvard, Yale, Stanford, MIT etj.

1.3. Hipotezat

Për qëllime hulumtuese, gjatë studimit të temës së parashtruar të këtij punimi të magjistraturës, do të parashtrujmë hipotezat si më poshtë, të cilat gjatë shtjellimit dhe përpunimit të këtij studimi do të vërtetohen apo do të mohohen me realizimin ose mosrealizimin e tyre. Me qëllim të realizimit të këtij hulumtimi do të parashtrujmë hipotezat në vijim:

Hipoteza 1:

- MOOC rrisin mundësinë dhe interesin për arsimim dhe zhvillim profesional gjatë gjithë jetës.

Hipoteza 2:

- Me anë të MOOC mësohet më lehtë dhe më shpejt sesa në klasë.

Hipoteza 3:

- Gjuha në të cilën ofrohet një MOOCs ndikon në përvetësimin e përmbajtjeve.

1.4. Pyetjet kërkimore

Duke pasur parasysh tematikën që ky punim magjistrature trajton, si dhe hipotezat e vendosura më sipër, kjo tezë magjistrature tërheq më tepër pyetje kërkimore edhe atë si në vijim:

1. Cilat janë llojet e MOOC që përdoren në rajonin tonë?
2. Kush janë përdoruesit e MOOC dhe kush përfiton nga MOOC?
3. A e rrit MOOC interesimin dhe mundësinë për arsim gjatë gjithë jetës?
4. Cila është mënyra më efikase e përdorimit të MOOC?
5. Çfarë ndikon në përvetësimin e përmbajtjeve gjatë ndjekjes së ligjëratave në MOOC?
6. Cili është perceptimi i palëve të interesit për MOOC?

1.5. Metodologjia e hulumtimit

Gjatë bërjes së hulumtimit të këtij studimi, apo teze të magjistraturës, do të përdorim më tepër metoda hulumtuese edhe atë si në vijim:

Metoda analitike

Metoda analitike do të na mundësojë që të analizojmë situatën aktuale me përhapjen e MOOC dhe ndikimit të tij në arsimin sipëror por edhe në komunitetin e biznesit që do të jenë edhe objekt i këtij studimi.

Po ashtu, do të analizojmë të dhënat që do t'i mbledhim nga anketat e ndryshme në formë të pyetësorëve dhe intervistave.

Do të analizojmë edhe nivelin e angazhimit të universiteteve në drejtim të përdorimit të MOOC për profesorët dhe të punësuarit e tjerë në universitete. Po ashtu do të analizojmë edhe përdorimin e MOOC nga ana e komunitetit të biznesit.

Në fund, do të analizojmë edhe efikasitetin e MOOC në arsimimin dhe trajnimin apo edhe aftësimin e të gjitha palëve të interesit siç janë studentët, nxënësit, të punësuarit në sferën e arsimit dhe biznesit etj.

Metoda statistikore

Metodën statistikore do ta vëmë në përdorim për të krijuar një bazë të të dhënave, e cila do të na ndihmojë në analizimin e situatës aktuale me përdorimin e MOOC në rajon. Në fund, do të shpalosim të dhënat me anë të tabelave dhe grafikoneve, të cilat do të jenë të vendosura në brendi të kësaj teze të magjistraturës.

Metoda krahasimore

Metodën krahasimore do të vëmë në përdorim për të krahasuar llojet e MOOC si dhe përdorimin e tyre në rajon dhe botë. Do të krahasojmë edhe praktikën më të mirë të përdorimit të MOOC në rajon dhe botë. Do të mundohemi të krahasojmë edhe llojet e MOOC që ofrohen nga më tepër universitete prestigjioze në botë por edhe të organizatave të ndryshme si Coursera, Udacity, edX etj.

Anketa dhe intervista

Anketa dhe intervista do të përdoren për të anketuar dhe intervistuar palë të ndryshme të interesit që përdorin këto platforma për ofrim të kurseve të hapura masive online.

Studim rasti

Do ta analizojmë gjendjen aktuale sa i përket përdorimit të MOOC në vend dhe rajon.

Metodat e ndryshme të hulumtimit do të na ndihmojnë të nxjerrim përfundime cilësore si dhe rekomandime për sa i përket kurseve online MOOC në rajon dhe futjes në përdorim të këtyre platformave për mësim nga distanca nga rajoni jonë.

1.6. Mostra dhe mbledhja e të dhënave

Sa i përket mostrës të këtij punimi të magjistraturës, ajo është e përbërë nga dy grupe studentësh, në grupin e parë kishte 53 studentë nga të cilët 37 ishin meshkuj ndërsa 16 ishin femra, përderisa në grupin e dytë 71 studentë, 49 ishin meshkuj ndërsa 22 femra. Të gjithë këta studentë studiojnë shkencat kompjuterike (CST) në UEJL.

Të gjithë këtyre studentëve iu garantua anonimiteti për sa i përket identitetit të tyre apo edhe përgjigjeve të dhëna nga secili nga ata studentë që u anketuan.

Të gjithë këta studentë pruan vullnetarisht të marrin pjesë në këtë hulumtim për të cilën gjë jemi falënderues.

1.7. Arsyeshmëria e studimit

Arsyeshmëria e këtij studimi qëndron në faktin se kjo tezë e magjistraturës do të nxjerrë në pah praktikën më të mirë të përdorimit të kurseve të hapura masive online që ka bërë një ndryshim të madh në paradigmat e të mësuarit nga distanca. Po ashtu, ky studim do të nxjerrë në pah llojet e ndryshme të platformave dhe organizatave që kohëve të fundit po ofrojnë kurse të hapura masive online dhe që po afrojnë universitetet më të njohura botërore pranë çdo individi në gjithë rruzullin tokësor. Ky studim do të na ndihmojë edhe në drejtim të krijimit të një pasqyre më të qartë se çfarë janë këto kurse masive dhe çfarë ndikimi këto kanë në zhvillimin dhe aftësimin e çdo individi që është i interesuar për t'u aftësuar në punën e tij ose saj si dhe nëse këto kurse masive mund të rrezikojnë universitetet lokale apo përkundrazi të ndihmojnë ato duke iu ofruar studentëve dhe profesorëve zhvillimin shtesë të aftësive të tyre si dhe fitimin e njohurive të reja shtesë.

KAPITULLI 2 – KONCEPTI I MOOC-ave

2.1. Përkufizimi i konceptit MOOC dhe origjina e tij

MOOC kohën e fundit janë bërë shumë të njohura në arsimin e lartë, por jo vetëm në arsimin e lartë. MOOC janë përhapur gjithandej fushave të ndryshme shkencore dhe në komunitetin e biznesit duke u mundësuar palëve të ndryshme të interesit qasje në mësim nga distanca, zhvillim profesional dhe kryerje të kurseve të certifikuara online (Daniel, 2012; Siemens, 2012; Chen W & Jia J. 2016).

Koncepti MOOC është një term teknologjik që në masë të madhe u përhap dekadën e fundit. Akronimi MOOC që në fakt qëndron për Massive Open Online Courses në përkthim në gjuhën shqipe do të thotë ‘Kurse Masive të Hapura Online’.

Sidoqoftë, për MOOC janë dhënë përkufizime të ndryshme. Disa nga ato do të shpalosim në vijim të këtij nënkapitulli.

Sipas Yousef et al (2014) akronimi MOOC përmban katër fjalë që kanë domethënien si më poshtë:

- **M** - Masiv: Në MOOC, masiviteti reflekton numrin e madh të pjesëmarrësve në kurs. Ndërsa shumica e MOOC kanë disa qindra kurse që arrijnë mbi 150,000 regjistrime (Allen dhe Seaman, 2013, Russell et al. 2013, Anderson dhe McGreal, 2012; Yousef et al, 2014);

- **H** - Hapur: Hapja përfshin katër dimensione (4R) Ripërdor, Rishiko, Ripërziej, dhe Rishpërndaj (Peter dhe Deimann, 2013; Yousef et al, 2014). Në kontekstin e MOOC, hapja i referohet ofrimit të një përvoje mësimore një numri të madh të pjesëmarrësve nga e gjithë bota pavarësisht nga vendndodhja, mosha, të ardhurat e tyre, ideologjia, dhe niveli i arsimit, pa asnjë kërkesë për regjistrim, ose për të tarifën e kursit për të pasur qasje në arsim cilësor. Hapja mund t'i referohet gjithashtu edhe sigurimit të burimeve të hapura arsimore (OER) p.sh. shënime kursi, prezantime në PowerPoint, video leksione, dhe vlerësim (Anderson dhe McGreal, 2012; Schuwer et al., 2013; Yousef et al, 2014);

· **O** - Online: termi në internet i referohet qasjes në kurs që bëhet përmes lidhjes së internetit për të siguruar sinkron si dhe bashkëveprimi asinkron midis pjesëmarrësit e kursit (Brown, 2013; Schuwer et al., 2013; Yousef et al, 2014);

· **K** - Kurse: Termi i kursit përcaktohet si njësi mësimore. Në MOOC kursi i referohet kurrikulës akademike që duhet të ofrohet për nxënësit, përfshirë burimeve të hapura arsimore, objektivat e të mësuarit, mjetet e rrjetit, vlerësimet, dhe mjete analitike të të mësuarit (Allen dhe Seaman, 2013; Voss, 2013; Yousef et al (2014).

Ndërsa, sipas AlDahdouh, Alaa A. & Osório, António J., (2016) MOOC qëndron për Kurset Masive të Hapura Online që kanë dy karakteristika që dallojnë këto kurse nga ato që ofrohen nëpërmjet platformave për mësim në distancë që ishin në përdorim para paraqitjes së MOOC: 1. hapja dhe 2. masiviteti. Hapja është një nga konceptet thelbësore të Konektivizmit.⁷ Siç potencon Downes (2012:11: AlDahdouh, Alaa A. & Osório, António J., (2016) "tema e 'hapjes' në arsim ishte mjaft e gjerë sa të kërkohej një vepër e veçantë." Në kuptimin e përgjithshëm, hapja në Konektivizëm do të thotë një liri e pjesëmarrjes dhe një transparencë e përmbajtjes dhe dizajnit apo modelit dhe një liri për mësimdhënie dhe nxënie nga distanca nëpërmjet internetit dhe pajisjeve më të reja teknologjike (Jacoby, 2014; Downes, 2012; Weller et al, 2012: AlDahdouh, Alaa A. & Osório, António J., 2016). Nga këndvështrimi i studentëve kursi është plotësisht i arritshëm dhe falas dhe nuk kërkohet asnjë identifikim dhe asnjë kusht apo certifikim i mëparshëm në kurs. Kështu, kursi mund të ketë një spektër heterogjen të studentëve me prejardhje të ndryshme etnike, kulturore, sociale apo edhe për mosha të ndryshme. Masiviteti i referohet mundësisë për të tërhequr një numër shumë të madh të studentëve (Weller et al, 2012: AlDahdouh, Alaa A. & Osório, António J., 2016). Mund të shihet se masiviteti është rezultat i prezantimit të një kursi në një mjedis të rrjetëzuar. Si pasojë, është normale të shohësh një MOOC të vetëm me një numër

⁷ Sipas Wikipedia, konektivizmi është një kornizë teorike për të kuptuar të mësuarit në një epokë dixhitale. Konektivizmi potencon mënyrën se si teknologjitë e internetit si shfletuesit e internetit, motorët e kërkimit, wikis, forume diskutimi në internet dhe rrjetet sociale kontribuuan në metodologjinë e re të të mësuarit. Teknologjitë u kanë mundësuar njerëzve të mësojnë dhe të ndajnë informacione në të gjithë rrjetin mbarëbotëror dhe ndërmjet tyre në mënyra që nuk ishin të mundshme para epokës dixhitale. <https://en.wikipedia.org/wiki/Connectivism>
George Siemens dhe Stephen Downes (Siemens & Downes, 2009) zhvilluan një teori për epokë dixhitale, e quajtur konektivizëm - denoncimi i kufijve të bihevizmit, kognitivizmit dhe konstruktivizmit. Teoria e tyre e propozuar e të mësuarit ka lëshuar një debat nëse është një mësim teori ose teori udhëzuese ose thjesht një pamje pedagogjike (Duke, Harper dhe Johnston, 2013, f. 1). Të mësuarit nuk ndodh thjesht brenda një individi, por brenda dhe përmes rrjeteve. Konektivizmi përkufizohet si "njohuri vepruese, ku kuptimi se ku mund të gjeni njohuri apo dije mund të jetë më i rëndësishëm sesa të përgjigjeni se si ose çfarë përfshin ajo njohuri apo dije" (Duke, Harper dhe Johnston, 2013, f. 7).

të studentëve që tejkalojnë numrin e tërësishëm të studentëve të regjistruar në disa universitete (Markoff, 2011). Pjesëmarrja është fjala kyçe e MOOC. Në fakt, pjesëmarrja është tipari kryesor i MOOC që e dallon atë nga Open Courseware (OCW) dhe Burimet e Hapura Arsimore (OER) (Littlejohn, 2013). MOOC nuk është vetëm përmbajtja e paraqitur në internet falas por është edhe çështje veprimesh, lidhjesh dhe aktiviteteve. Të mësuarit ndodh gjatë lidhjes së njeve; "Tubi është më shumë i rëndësishëm sesa përmbajtja brenda tubit, thjesht sepse përmbajtja ndryshon me shpejtësi" (Siemens, 2006, f. 32).

Nga literatura e shfletuar mund të mësojmë se pavarësisht faktit që MOOC si ofertë për kurse masive akademike online u përhapën shumë shpejt, ato në fillim nuk kishin ndonjë famë të madhe si dhe nuk ishin të njohura për opinionin e gjerë. Ato kryesisht dilnin në pah në mjedise më pak akademike si p.sh. raporte mediatike dhe revista tregtare por jo edhe në revista ndërkombëtare të hulumtimeve shkencore edhe përkundër faktit që këto kurse online ishin pikërisht të ofruara nga universitetet më të njohura në botë siç janë Stanford, Yale, Harvard etj. Kohët e fundit MOOC filluan të dalin në pah dhe të studiohet nga studiues të ndryshëm të cilët edhe hulumtonin ndikimin e MOOC në sfera të ndryshme të jetës si dhe studimet e tyre i botonin në revista të vlerësuara ndërkombëtare të hulumtimeve shkencore (Gasevic, Kovanovic, Joksimovic, & Siemens, 2014; Liyanagunawardena, Adams, & Williams, 2013; Siemens, Irvine, & Code, 2013; Chen W & Jia J. 2016).

Sa i përket origjinës së Kurseve Masive të Hapura Online (MOOC) ajo mund të gjurmohet qysh në vitet e para të shekullit 21, gjegjësisht në fillim të vitit 2000, kur edhe u shfaqën kurset e para të hapura online (Zawacki Richter & Naidu, 2016). Gjatë kësaj periudhe, Universiteti MIT kishte nisur të publikojë në ueb të hapur lëndë të ndryshme nga programe të ndryshme studimore. Ky sistem i hapur për publikime të materialeve nga të gjitha lëndët universitare dhe pasuniversitare të MIT me qasje të lirë dhe të hapur ndërkombëtarisht u quajt MIT OpenCourseWare (OCW). Përdorim i gjerë i këtij sistemi filloi nga pranvera e vitit 2001. Në shkurt të vitit 2005, OpenCourseWare zyrtarisht lëvizi përtej MIT me inaugurimin e Konsorciumit të OpenCourseWare (OCW). Më pak se një vit më vonë, Konsorciumi përfshiu më shumë se 100 universitete dhe organizata të tjera anëtare që mbështesin hapjen e publikimit të hapur të materialeve të më shumë se 3000 lëndëve studimore. OpenCourseWare (OCW) u bë lëvizje emblematike e lëvizjes për "Burime të hapura të arsimit" një shprehje e miratuar për herë të parë në Forumin e UNESCO-s në vitin

2002 mbi ndikimin e Kurseve të hapura në arsimin e lartë në vendet në zhvillim. Kjo shprehje në fakt ishte një dëshirë e të gjithë atyre që merrnin pjesë në atë takim dhe që të gjithë dëshironin që të zhvillojnë një Burim të Hapur Universal Arsimor i cili do të ishte në dispozicion të njerëzimit (Abelson, 2008: 164-165).

Si rrjedhojë e asaj që u përmend më lart, viti 2008 shënoi vendosjen e gurthemelit të MOOC. Personi që i pagëzoi këto kurse online me termin MOOC ishte Dejev Cormier (Hollands & Tirthali, 2014). Sipas McAuley et al (2010) MOOC ishin një dukuri e jashtëzakonshme në internet që grumbullonte vull gjatë viteve 2008-2010 apo edhe më herët. Sipas tyre, MOOC integrohet nëpërmjet lidhjes së rrjeteve sociale, mundësimin të zhvillimit të ligjëratave të ndonjë eksperti të njohur në një fushë të caktuar shkencore, dhe vendosjes së një koleksioni të burimeve online në të cilat qasja është shumë e lehtë (McAuley et al, 2010). McAuley et al (2010) potencojnë faktin që ajo që karakterizon MOOC megjithatë është se ato bazohen në angazhimin më aktiv të disa qindra deri në disa mijëra "studentëve" të cilët vetëorganizojnë pjesëmarrjen e tyre në përputhje me qëllimet e të nxënies, njohuritë dhe aftësitë e mëparshme, dhe interesave të tyre. Një MOOC zakonisht nuk mbart tarifa, dhe nuk ka nevojë për asnjë parakusht tjetër përveç qasjes në internet pa pritje të paracaktuara për pjesëmarrje dhe pa asnjë akreditim zyrtar (McAuley et al, 2010).

Siç përmendëm më lart, oferta e parë MOOC i atribuohet kurseve arsimore të quajtur 'Konektivizmi dhe Njohuritë Lidhëse' në Universitetin e Manitoba. Ajo iu ofrua 25 studentëve në vitin 2008 të cilët kishin paguar shkollim dhe përveç kësaj për më shumë se 2000 studentëve që nuk ishin të regjistruar në universitet. Megjithatë, deri në vitin 2012, MOOC u bë një fjalëkalim me fillimin e platformës në internet edX nga MIT dhe Harvard, Udacity nga Sebastian Thrun, dhe platforma Coursera nga profesorët e Stanfordit, Dafni Koller dhe Andrew Ng së bashku me një rrjet të 33 universiteteve të tjera. Kishte edhe platforma të tjera bashkëpunuese në internet që u ndoqën më pak, të tilla si Udemy, FutureLearn në Mbretërinë e Bashkuar, universitete në Gjermani, dhe platforma në shumë vende të tjera në të gjithë botën. Përmes platformave MOOC, përdoruesit e internetit kudo në botë mund të regjistrojnë kurse të ndryshme sipas nevojave të tyre, qofshin ato arsimore apo për zhvillim profesional (K. Ingolfsdottir, 2014).

Më tej është më rëndësi të përmendim që në një artikull të New Yorker, Rektori i Universitetit të Stanfordit, John Hennessy kishte shkruar, "Po vjen një tsunami" (Auletta, 2012, f. 71) dhe Daphne Koller, profesor i Shkencave Kompjuterike në Universitetin e Stanfordit dhe bashkëthemeluesi i Coursera, iu kishte përgjigjur duke thënë "Cunami po vjen, duam apo jo. . . Ju mund të shtypni ose të surfoni dhe është më mirë të surfoni" (McKenna, 2012, para.2). Por, parakusht për MOOC që të transferohen në një cunami duhet shqyrtuar dhe analizuar gjendjen aktuale të hulumtimeve të MOOC dhe ndikimit të tyre gjithandej (Bozkurt, A., Özdamar Keskin, N., & de Waard, I. 2016). Në linjë të njëjtë janë edhe McAuley et al (2010) të cilët potencojnë, gjegjësisht nxjerrin në pah mungesën e hulumtimeve përkatëse për potencialin e MOOC, si një dukuri arsimore, për të ndihmuar pjesëmarrjen më të gjerë në një ekonomi dixhitale. Për më tepër, numri i përgjithshëm i MOOC të ofruara gjatë dy viteve të para 2008-2010 ishte shumë i vogël ose më mirë thënë simbolik (McAuley et al, 2010).

Më tutje, McAuley et al (2010) nxorën në pah edhe një agjendë koherente të kërkimit që do të ndihmonte në vlerësimin e qëndrueshmërisë së përgjithshme të modelit të MOOC dhe kushtet në të cilat ato mund të arrijnë potencialin e tyre. Sipas tyre çështjet specifike pedagogjike, sfidat dhe pyetjet përfshijnë shkallën në të cilën mund të mbështesë hulumtimin thelbësor dhe krijimin e njohurive të avancuara, gjerësia kundrejt thellësisë së pjesëmarrjes. Po ashtu, shqyrtoheshin edhe kushtet për pjesëmarrje të suksesshme që mund të shtriheshin përtej atyre me qasje më të gjerë dhe aftësi të sofistikuar të rrjeteve sociale. Mandej, identifikimin e proceseve dhe praktikave që mund të inkurajojnë personat e fshehur, ose "pjesëmarrësit legjitimë periferikë", për të marrë role më aktive dhe qendrore si dhe ndikimi ose vlera e pjesëmarrjes, posaçërisht shkalla në të cilën MOOC merr pjesë e që mund të kontribuojnë në pjesëmarrjen në ekonominë dixhitale në praktikat ekstra-MOOC. Në fund është strategjia specifike për të maksimizuar kontributin efektiv të lehtësuesve në veçanti dhe pjesëmarrësve më të përparuar në përgjithësi si dhe rolin e akreditimit, nëse ka, dhe si mund të zbatohet (McAuley et al, 2010).

Më tutje, në vitin 2011, Sebastian Thrun dhe kolegë të tjerë në Universitetin e Stanfordit ofruan në kurs akademik falas mbi inteligjencën artificiale (AI) për të siguruar një mundësi arsimore për këdo që dëshironte të ndiqte atë lëndë nga distanca nëpërmjet internetit. Duhet cekur faktin se njëqind e gjashtëdhjetë mijë pjesëmarrës nga 190 vende të

ndryshme të botës u regjistruan në atë kurs. Në një nivel të ngjashëm ndiqeshin MOOC në shumë universitete dhe institucione arsimore të tjera të cilët po ashtu filluan të ofrojnë MOOC (Waldrop, 2013). Waldrop (2013) vuri në dukje se për më pak se dy vjet, 328 kurse të hapura elektronike u nisën nga 62 institucione arsimore, duke regjistruar 2.9 milionë studentë nga 220 vende. Këto shifra konfirmojnë premisën se të mësuarit është i arritshëm për të gjithë ata që duan të mësojnë pa kufizime. Ata përdorin faqet e rrjeteve sociale (Twitter, Facebook, dhe blog) për të shkëmbyer përvoja dhe për të mësuar nga të tjerët (Waldrop, 2013).

Përveç kësaj, në vitin 2011, MOOC që reflektonin trende të konsiderueshme të zhvillimit në arsim u prezantuan edhe nga disa organizata si Coursera, Udacity dhe edX. Kjo përpjekje u pasua nga një përgjigje e shpejtë nga universitetet ndaj konceptit dhe praktikës së të mësuarit në internet në të cilën janë bashkuar miliona studentë dhe pjesëmarrës të tjerë në një bazë globale. MOOC mbulonin shumë lëndë, duke përfshirë shkencat humane, mjekësinë, biologjinë, shkencat shoqërore, matematikën, biznesin, shkencat kompjuterike etj. Studentët merrnin pjesë pa pasur nevojë të paguajnë shkollim ose tarifa të tjera ose të braktisin punën e tyre. Shumë njerëz filluan të spekulojnë nëse MOOC do të prishin arsimin e lartë nga poshtë lart. Pas suksesit spektakolar të kursit të Inteligjencës Artificiale të Thrun, Coursera nisi të ofrojë dy kurse të tjera nga Universiteti i Stanfordit (Waldrop, 2013).

Megjithatë, viti gjatë të cilit Kurset Masive të Hapura Online (MOOC) do të tërhiqnin vëmendjen e mediave publike, bizneseve, mësuesve dhe nxënësve nga e gjithë bota do të ishte viti 2012, kur New York Times vendosi ta emërojë vitin si "Viti i MOOC". MOOC u perceptuan si një mjet shumë i fuqishëm për të përmirësuar përvojën e studentëve dhe nxënësve në arsimin në distancë, ndërsa zgjeron numrin e studentëve që mund të kenë qasje në arsim të lartë. Të gjitha palët si ofruesit e kurseve të hapura online po ashtu edhe ata që do të ndiqnin ligjëratat nga distanca në universitet më të njohura botërore ishin të ngazëlluar nga MOOC. Komuniteti i Biznesit gjithashtu perceptuan hyrjen e MOOC në arsimin e lartë si një mundësi për zhvillimin e modeleve të reja të biznesit (Ruipérez-Valiente, J. A. et al, 2020). Në mars të vitit 2012 Universiteti i MIT, i cili ishte themelues i një platforme tjetër të MOOC, edX, inicioi zhvillimin e një platformë të lirë dhe të hapur për të mësuar në internet. edX ishin të dizajnuara për të lejuar organizimin e materialeve të postuara nga profesorët për të rritur konceptet dhe njohuritë përmes ushtrimeve

ndërvepruese. Kurset ishin dizajnuar në atë mënyrë që ndihmonin përhapjen e koncepteve të reja shpejt dhe në mënyrë efektive. Më tej, ata përdorin ndërveprimin e përdoruesve për të siguruar pjesëmarrjen e studentëve dhe mbajtjen e tyre për një kohë të gjatë, duke siguruar reagime në mënyrë që përparimi i nxënësve të monitorohet dhe vlerësohet (Armstrong, 2012).

Ndërsa në tetor të vitit 2018, edX prezantoi 9 programe të reja të studimeve master të cilat u ofruan nga universitetet më të njohura të botës dhe të cilat kishin mundësi të zhvilloheshin plotësisht online (MarketDigits, 2021). Disa muaj më herët, më saktë në muajin mars të vitit 2018, Coursera bashkëpunoi me 5 universitete për të zgjeruar ofertat e saja për programet master dhe bachelor për të nxitur regjistrimin e më shumë studentëve. Kurse, në qershor të vitit 2018, LinkedIn bashkëpunoi me ofruesit e LMS - Cornerstone OnDemand dhe SAP SuccessFactors për të rritur avancimin dhe arritjen e studentëve të LinkedIn në faqet e internetit të kompanive përkatëse.

Më vonë, në mars të vitit 2020, Udacity, Inc. hyri në një partneritet me Nutanix, e cila merret me 'Informatikë në Re'. Përmes këtij partneriteti, kompania ofron një Program Moderne Hybrid Cloud Nanodegree. Ky program do të azhurnojë hapjet e të mësuarit brenda ekspozitës së inovacioneve në re që janë thelbësore për organizatat për të ngritur bazën e tyre të IT. Ky partneritet ndihmon kompaninë të rrisë kategorinë e kurseve të saj për informatikë në re (MarketDigits (2021)).⁸ Ndërsa, në maj të vitit 2020, edX Inc. nisi një aktivitet në të gjithë botën për të ndihmuar kolegjet që përballen me sfidën e aktualizimit të mësimit nëpërmjet internetit, gjegjësisht nga distanca.

Siç pamë më sipër, MOOC janë ballafaquar me sfida të mëdha dhe përhapja e tyre në botë nuk shkoi edhe aq shpejt. Mirëpo, duke pasur parasysh që MOOC ofrojnë mundësi të vlefshme arsimore për miliona studentë të mundshëm nga e gjithë bota, ato do të vazhdojnë të evoluojnë me kalimin e kohës dhe do të jenë pjesë e të gjitha institucioneve si arsimore ashtu edhe të bizneseve.

⁸© 2021 GlobeNewswire, Inc. All Rights Reserved.

2.2. Dizajnimi apo modelimi i MOOC dhe rëndësia e tyre

Pavarësisht faktit që MOOC gëzon një popullaritet në opinion, shumë studiues bien dakord se ka nevojë për hulumtime dhe eksperimentime të vazhdueshme në lidhje me dizajnimin apo modelimin e MOOC [McAuley et al., 2010, Ostashewski dhe Reid, 2012: Alario-Hoyos Carlos et al, 2014]. Në fakt, në literaturë, ekzistojnë shumë pak hulumtime që studiojnë aspektet përkatëse të MOOC (GCB, 2012; Guàrdia et al., 2013; McAndrew, 2013; Siemens, 2012a; Alario-Hoyos, et al, 2014). Sipas Alario-Hoyos, et al (2014) deri më tani MOOC janë klasifikuar dhe krijuar apo dizajnuar zakonisht nga dy perspektiva, siç përcaktohet nga Stephen Downes: xMOOC dhe cMOOC (Siemens, 2012a: Alario-Hoyos, et al, 2014). Të dy modelet ndajnë shumicën e karakteristikave për sa i përket burimeve multimediale, numër masiv të nxënësve dhe kurseve të dislokuara për një seri ligjëratash disa javore. Dallimi kyç qëndron tek roli i ligjëruesve dhe studentëve në kurs, si dhe në mënyrën se si arrihen rezultatet e të mësuarit (Rodriguez, 2012; Siemens, 2012a: Alario-Hoyos, et al, 2014). Sipas Ostashewsky & Reid (2012), xMOOCs angazhojnë një njohësbijehviorist dhe përhapje e njohurive bëhet me anë të qasjes pedagogjike të ngjashme me atë të kurseve tradicionale ballë për ballë dhe në internet. Ndërsa, cMOOC ndjekin më shumë qasje të të mësuarit konektivist, ku dija gjendet në lidhjet ndërmjet studentëve, dhe të mësuarit në fakt paraqet zhvillim dhe përshkrim të atyre lidhjeve (Siemens, 2005).

Ndërsa, kohën e fundit u shfaqën disa iniciativa për të përcaktuar klasifikime për MOOC. Një nga nismat kryesore në këtë linjë është ajo e propozuar nga Conole (Conole, 2013). Ajo klasifikon MOOC sipas dymbëdhjetë dimensioneve: “Shkalla e hapjes, shkalla e pjesëmarrjes, sasia e përdorimit të multimedias, sasia e komunikimit, shkalla në të cilën përfshihet bashkëpunimi, lloji e rrugës së nxënësit, niveli i sigurimit të cilësisë, shkalla në të cilën është reflektimi, inkurajuan nivelin e vlerësimit, sa joformal dhe formal është, autonomia dhe larmia ” (Alario-Hoyos C., Perez-Sanaugustin M., Cormier D., Delgado-Kloos C.). Conole shprehet se këto dymbëdhjetë kritere mund të përdoren jo vetëm për klasifikimin e MOOC, por edhe për të planifikuar dizajnin e MOOC edhe atë gjithmonë nga një perspektivë pedagogjike. Megjithatë, kur dizajnon një MOOC, jo vetëm qasja pedagogjike që do të duhej të ndiqet (mënyrat siç referohen nga Conole) ose objektivat e të nxënësve që duhet të jenë ndikimi i arritur në projektin përfundimtar. Më tutje, ka çështje të

tjera teknologjike, logjistike dhe ato të natyrave financiare për t'u konsideruar (p.sh. platforma teknologjike në të cilën MOOC i vendosur ka një ndikim në llojin e aktiviteteve vlerësuese të mbështetura, përderisa burimet njerëzore të disponueshme kushtëzojnë sasinë e përmbajtjes që mund të jetë prodhuar). Në të vërtetë, kjo nuk është asgjë e re, dhe Conole dhe Mulholland (2007) tashmë identifikuan që modelet e të mësuarit, në përgjithësi, mund të shihen nga tri sfera: 1. arsimore, e cila përshkruan qëllimet pedagogjike 2. sfera teknologjike, e cila përcakton teknologjitë që do të përdoren si dhe 3. sfera logjistike, e cila përshkruan se si dy sferat të tjera lidhen dhe veprojnë (Alario-Hoyos Carlos et al, 2014).

Sa i përket çështjeve e natyrës logjistike, ligjëruesit duhet të jenë të vetëdijshëm se krijimi dhe dizajnimi si dhe drejtimi i një MOOC mund të jetë një detyrë e cila do të kryhet për një kohë shumë të gjatë, dhe prandaj duhet planifikuar me kujdes realizueshmëria e një MOOC. Hulumtimi i bërë nga Kolowich (2013) nxjerrë në pah të dhënat që një MOOC zakonisht merr mbi 100 orë para se të drejtohet kursi për herë të parë, dhe mesatarisht edhe 10 orë të tjera në javë gjatë përdorimit të saj. Kolowich (2013) thekson se shumica e arsimtarëve nuk janë në gjendje të mbajnë një ekuilibër kur drejtojnë MOOC, duke e larguar kohën nga detyrat e tyre normale siç do të ishte rasti me paradigmen tradicionale të mësimdhënies. Këto numra do të vareshin për shembull nga tema dhe kohëzgjatja e kursit dhe mbi sasinë e materialeve që duhet të sigurohen për një kurs siç janë regjistrimi i videove merr shumë më shumë kohë sesa sigurimi i lidhjeve me burimet ekzistuese të hapura arsimore.

Nga ana tjetër, për sa i përket çështjeve teknologjike, ligjëruesit duhet të jenë të qartë për mbështetjen e sistemit të cilin do ta përdornin për të drejtuar MOOC. Në ditët e sotme, shumica e ligjëruesve përdorin platforma për të centralizuar hyrjen në përmbajtjen e të mësuarit (ose duke postuar burime bibliografike) në platformë ose duke përfshirë linke që ridrejtojnë tek burimi origjinal (Siemens, 2011). Deri tash ka shumë institucione arsimore, në veçanti të atyre të arsimit të lartë, që nënshkruajnë marrëveshje me Coursera, edX ose MiríadaX, dhe të njëjtat inkurajojnë stafin e tyre të vendosin përmbajtje mësimore në platformat e mbajtura nga këto kompani. Prandaj, ligjëruesit duhet të jenë shumë të vetëdijshëm për mundësitë financiare të siguruara nga platformat mbështetëse në kohën e dizajnit të MOOC, meqenëse ato mund të përcaktojnë, për shembull, formatin e

përmbajtjes së të nxënit ose llojet e vlerësimit aktivitetëve që mund të mbështeten (Siemens, 2011).

Ndërsa, në lidhje me çështjet pedagogjike, ligjëruesit duhet të ndryshojnë mënyrën e tyre të mendimit nga kurse me prezencë fizike në ato nëpërmjet internetit (Hill, 2012), pasi që në MOOC përfshihen një numër i madh i studentëve nga vende të ndryshme të botës, me prejardhje të ndryshme, status dhe motive të ndryshme. Për më tepër, për shkak të kufizimeve kohore, ligjëruesit nuk mund të luajnë një rol qendror në MOOC dhe kështu, didaktikat që promovojnë autonominë e nxënësit (Downes, 2010) dhe lejojnë ndërveprimin e studentëve (Kop et al., 2011) duhet të hulumtohen dhe të krijohet një metodologji e re e mësimdhënies gjatë ekzekutimit të MOOC.

Së fundmi, çështjet financiare mbulojnë dy aspekte të ndryshme në MOOC. Aspekti i parë merr në konsideratë sasinë e parave që mund të investojnë ligjëruesit (dhe institucionet) për të dizajnuar dhe ekzekutuar MOOC. Aspekti i dytë merret me të ardhurat që mund të përfitohen nga MOOC (Kolowich 2012).

Pra, gjatë dizajnit të MOOC, që është një proces kompleks dhe aspak i lehtë, kërkon mekanizma që duhet të jenë të thjeshtë dhe të kuptueshëm pasi në MOOC mund të ligjërojë çdo ligjërues dhe duhet të jenë të zbatueshme për një gamë të gjerë të fushave të dijes. Dhënia e mbështetjes për ligjëruesit gjatë dizajnit të MOOC fillon të zgjojë interes në sferën akademike dhe tashmë ka disa punime shkencore që ofrojnë këshilla të përgjithshme (GCB, 2012, Guàrdia et al., 2013: Siemens, 2012a]. Sidoqoftë, edhe përkundër udhëzimeve të shumta që dalin nga hulumtime të ndryshme në asnjë hulumtim nuk ofrohen mekanizma të thjeshtë dhe të kuptueshëm për të dizajnuar MOOC (Conole, 2008a).

Sipas Conole (2008) dizajni i një kursi arsimor është një fushë kërkimore që ofron mjete dhe metoda për artikulum dhe përfaqësim të procesit të dizajnit të përvojave të të mësuarit, duke i bërë ato më eksplicite dhe të ndara dhe ndihmon ligjëruesit në procesin e planifikimit dhe organizimit të ngjarjeve arsimore të shëndosha pedagogjike (Conole, 2008).

Metodat dhe mjetet e dizajnit mësimor janë treguar veçanërisht të dobishme kur merren parasysh kontekste komplekse të të mësuarit, siç është rasti i MOOC, në të cilat janë të përfshirë një numër i konsiderueshëm i burimeve dhe palëve të interesuara (Conole, 2010). Conole (2010) argumenton se paraqitjet e modelit apo dizajnit mund të kenë disa

formate (verbale, tekstuale, vizuale ose të bazuara në të dhëna) dhe mund të përdoren për të përshkruar aspekte të ndryshme të ciklit të dizajnit (nga aktivitetet e të nxënësve në shkallë të vogël në një tërësi kurrikulare) (Conole, 2010). Sipas Conole (2010) ajo që është e dukshme është se dizajni është një proces krijues, i çrregullt dhe përsëritës. Ligjëruesit mbështeten shumë në njohuritë dhe përvojën e mëparshme gjatë dizajnit të kursit dhe rrallë ndjekin ndonjë lloj procesi formal të dizajnit të një kursi. Kjo nuk është problematike në situatat kur ligjëruesit punojnë brenda parametrave të njohur, por bëhet problematike kur ata duhet të nxjerrin skema të reja brenda një konteksti gjithnjë e më kompleks i të mësuarit, ku ekziston një numër pothuajse i pafund i burimeve dhe mjeteve që atyre mund t'u pëlqejnë. Në të vërtetë, gjatë dizajnit të një kursi duhet të merren parasysh më tepër aspekte dhe pjesë përbërëse të një lëmie apo lënde mësimore (Conole, 2008; Conole, 2010). Këto përfshijnë llojin e pedagogjisë duke u përdorur konteksti në të cilin do të miratohet veprimtaria mësimore, llojet e rezultateve të synuara të të nxënësve lidhur me veprimtarinë, natyrën dhe numrin e detyrave që duhet të ndërmerren nga nxënësi, mjetet shoqëruese dhe burimet që ata do të përdorin dhe çdo vlerësim formues ose përmblendhës. Për më tepër, secili prej këtyre nën-përbërësve kanë ndërvlerë; llojet e pedagogjisë së zgjedhur do të ndikojnë në detyrat e ndërmarra nga studenti; mjetet e ndryshme ndikojnë në përvojën e të mësuarit, vlerësimi shpesh është një faktor kryesor në të mësuarit dhe prandaj natyra e vlerësimit ka një ndikim të rëndësishëm në mënyrën në të cilën do të bëjë që nxënësi të angazhohet në kursin përkatës (Conole, 2010).

Studiues të tjerë ofrojnë zgjidhje më të bazuara teorikisht duke propozuar modele për të mbështetur dizajnimin e aktiviteteve të ndryshme të të nxënësve. Për shembull, modeli 4Ts (Persico dhe Pozzi, 2011) përcakton një skemë me katër përbërës të dizajnit duhet të përqendrohen kur punojnë në Mësimin Bashkëpunues të Mbështetur në Kompjuter (CSCL): Detyra, Skuadrat, Teknologjia dhe Koha. Gjithashtu, modeli 4SPPIces (PérezSanagustín et al., 2012) organizon katër faktorë: Hapësira, Pjesëmarrësit, Metoda Pedagogjike dhe Historia si elementet kryesore që duhet të merren parasysh gjatë dizajnit. Shembuj të tjerë të modeleve të konceptuara për të siguruar dizajnerë me mekanizmat për të prodhuar modele mësimore duke mbajtur ekuilibrin ndërmjet

teknologjisë dhe pedagogjisë janë të detajuara në sondazhin e Persico (Persico et al., në shtyp).⁹

2.3. Dimensionet dhe ideologjia e MOOC-ave

Lëvizja e burimeve të hapura arsimore (OER)¹⁰ i ka hapur rrugën konceptit ‘hapja e arsimit’, e cila sot është më e dukshme në debatet e vazhdueshme për MOOC - Kurset Masive të Hapura Online. Historikisht, qëllimi kryesor i arsimit të hapur ka qenë ofrimi i mundësisë për të pasur qasje në arsim nga distanca për studentët të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë pasur qasje në sistemin e arsimit tradicional (McAndrew, 2010; Littlejohn & Pegler, 2014; Dalsgaard & Thestrup, 2015). Sipas Dalsgaard & Thestrup (2015) qëllimi prapa arsimit të hapur nuk është pedagogjik, por rrjedh kryesisht nga politika arsimore (Dalsgaard & Thestrup, 2015).

Idetë origjinale të universiteteve të hapura dhe arsimit në distancë gjithashtu përbëjnë motivin kryesor për hapjen e arsimit sot, gjegjësisht për të arsimuar të gjithë ata që kanë qasje të kufizuar në sistemin arsimor tradicional. Po ashtu, këto nisma të hapura në arsim e në veçanti arsimin e lartë kanë qartësuar termin ‘i hapur’ rreth tre fushave kryesore të veprimtarisë: krijimin e softuerit me burim të hapur dhe mjeteve të zhvillimit, krijimin dhe sigurimin e përmbajtjes së kursit të hapur, si dhe zhvillimin e standardeve dhe mjeteve të licencimit (Albright, 2005). Sipas Albright (2005) termi ‘burimet e hapura arsimore’ është miratuar nga UNESCO për t’iu referuar sigurimit të hapur të burimeve arsimore, të mundësuar nga teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK), për konsultim, përdorim dhe adaptim për qëllime jokomerciale (Albright, 2005). Po ashtu, Albright (2005) shton se burimet e hapura arsimore (OER) përfaqëson një hap të madh drejt ndarjes së materialeve arsimore, metoda dhe mjete arsimore, ngjashëm me akademikët kur ndajnë punën e tyre në punime shkencore. Rezultati është të shtohen burimet e mësimdhënies duke zgjeruar mundësitë për përvetësim të dijeve nga ana e nxënësve dhe profesorëve (Albright, 2005).

⁹<https://elearningindustry.com/creating-a-mooc-cooc-6-steps>

¹⁰Burimet e Hapura Arsimore janë rezultat i një qasjeje tjetër ndaj arsimit: përqendrimi në ndarjen, përmirësimin dhe ripërdorimin e materialeve arsimore të krijuara nga njerëz (jo vetëm super-ekspertë) të cilët janë të gatshëm të ndajnë dijen e tyre me të gjithë. <https://www.mooc-list.com/tags/open-educational-resources>

Sidoqoftë, që nga krijimi i Burimeve të Hapura Arsimore (OER) në 2002 nga UNESCO arsimi i hapur ka zgjeruar konceptin e hapur drejt arsimit për të gjithë (Dalsgaard & Thestrup, 2015). Arsyeja kryesore prapa burimeve të hapura arsimore (OER) është përdorimi i mediave dixhitale për të siguruar qasje të lirë dhe të hapur në burimet arsimore që mund të kopjohen, shpërndahen dhe ripërdoren në të gjithë botën (Friesen, 2009).

Kështu, burimet e hapura arsimore (OER) kanë për qëllim të zgjerojnë synimet origjinale të arsimit të hapur, dhe si rrjedhojë, fokusi i burimeve të hapura arsimore (OER) vendoset tek shpërndarja, mundësia e përdorimit dhe ripërdorimit të burimeve të hapura (Friesen, 2009; Windle, Wharrad, McCormick, Laverty dhe Taylor, 2010; Dalsgaard & Thestrup, 2015).

Përveç ndikimit në politikat arsimore, dy aspektet më të rëndësishme të hapjes kanë të bëjnë me qasjen pa pagesë në Internet dhe sa më pak kufizime në përdorimin e burimit. Nuk duhet të ketë pengesa teknike (kode të fshehura), pa pengesa pagesash (tarifa licencimi, pagesa për shikim) dhe sa më pak pengesa ligjore për qasje të mundshme (të drejtat e autorit dhe kufizimet e licencimit) për përdoruesin përfundimtar. Përdoruesit e fundit duhet të jenë në gjendje jo vetëm të përdorin ose lexojnë burimin, por edhe ta përshtatin atë, të ndërtohen mbi të dhe në këtë mënyrë ta ripërdorin atë. Në terma të gjerë, kjo është ajo që nënkuptohet me "të hapur" në të tre mënyrat juridikisht, shoqërisht dhe teknologjikisht (<http://www.okfn.org>; Hylén, 2006).

Ashtu si burimet e hapura arsimore (OER), perspektiva e MOOC është që të sigurojë arsimim për të gjithë - në formatin e kurseve, jo (vetëm) burimeve. Edhe pse arsimi për gjithçka është një objektiv kryesor për MOOC, si dhe OER, debati që bëhet rreth MOOC disi i shtrembëroi diskutimet mbi konceptin e hapjes. MOOC janë, pa dyshim, një nga iniciativat më interesante brenda arsimit të hapur, por është e qartë nga kritikët masivë të MOOC se nuk janë përgjigjja e vetme për sfidat e arsimit të hapur. Përkundrazi, ka shumë sfida për hapjen e arsimit për një audiencë të madhe. Shkalla e ulët e përfundimit të kurseve nga ana e studentëve është theksuar si një sfidë kryesore e hapjes në internet, në veçanti MOOC (Chen, 2014; Daniel, 2012; Kizilcec, Piech and Schneider, 2013; Clow, 2013; Dalsgaard & Thestrup, 2015).

Sipas Dalsgaard & Thestrup (2015) pas hapjes së arsimit qëndrojnë motive ideologjike që kanë të bëjnë me hapjen për të gjithë dhe falas për të gjithë, motive të vendosjes së raporteve apo marrëdhënieve mes institucioneve, si dhe motive pedagogjike e kështu me radhë. Pra, ka më tepër motive dhe çdo motiv rezulton në konceptime shumë të ndryshme (Dalsgaard & Thestrup, 2015).

Ndërsa, sipas Dalsgaard dhe Paulsen (2009) pas hapjes së arsimit qëndrojnë tri dimensione. Dimensioni i parë i hapjes lidhet me mbështetjen e transparencës midis studentëve për të këmbyer informata rreth aktiviteteve të njëri-tjetrit, gjegjësisht lidhet me vënien në dispozicion të punës së studentëve për studentët e tjerë. Dimensioni i dytë lidhet me hapjen si komunikim midis studentëve dhe botës së jashtme, gjegjësisht objektivi është vendosja e komunikimit ndërmjet aktiviteteve arsimore të një kursi institucional dhe praktikave sociokulturore përreth tij. Transparenca është pikënisja për këtë lloj ndërveprimi. Dallimi është se grupi i synuar ka ndryshuar. Nga pikëpamja e institucionit, kjo formë e hapjes bëhet e mundur duke hapur aktivitetet arsimore, diskutimet dhe produktet për palë interesi jashtë pjesëmarrësve të kursit. Grupi i synuar për këtë format të hapur janë njerëzit që ndajnë një fushë të përbashkët interesi (Dalsgaard, 2006). Nga perspektiva e botës së jashtme, palët e interesit jashtë kursit gjithashtu mund të përpiqen të komunikojnë informacionin dhe praktikën e tyre, duke e bërë të mundur lidhjen me institucionet. Kjo do të përputhej me idetë e Dewey (1907)¹¹ për lidhjen e institucioneve arsimore dhe shoqërisë.

Ngjashëm me transparencën, ky dimension i hapjes nuk do të thotë domosdoshmërisht komunikim ose bashkëpunim i dyanshëm ndërmjet institucionit dhe partnerët e jashtëm. Mund të përfshijë komunikim dhe diskutim të dyanshëm ndërmjet institucionit dhe partnerë të jashtëm, por gjithashtu mund të kufizohet në një komunikim me një drejtim të synuar specifik me qëllim të ofrimit të kontributit dhe frymëzimit. Nga pikëpamja e institucioneve arsimore, qëllimi mund të jetë shpërndarja e diskutimeve aktuale brenda fushës akademike, ndërsa partnerët e jashtëm mund t'i paraqesin pyetje institucioneve arsimore ose të ofrojnë zgjidhje për sfida të ndryshme të botës reale. Dhe në fund, dimension i tretë i hapjes synon krijimin e marrëdhënieve të ndërvarura ndërmjet institucioneve arsimore dhe praktikave të jashtme. Qëllimi është që studentët dhe mësuesit të bëhen partnerë në zbulimin dhe zgjidhjen e problemeve aktuale së bashku me partnerë

¹¹https://brocku.ca/MeadProject/Dewey/Dewey_1907/Dewey_1907a.html

të tjerë që mund të jenë institucione, kompani ose organizata jofitimprurëse. Transparenca tani shndërrohet në komunikim aktual, kur ka një dialog të vazhdueshëm midis pjesëmarrësve të ndryshëm në një projekt. Komunikimi kthehet në angazhim përmes një detyre të përbashkët, e cila bëhet pika qendrore për angazhimin e ndërsjellë midis institucionit arsimor dhe partnerët e saj të jashtëm. Rrjedhimisht, formati i hapur i këtij dimensionit nuk është kurs, por përkundrazi e merr formën e një projekti ose detyre bashkëpunuese (Dalsgaard dhe Paulsen, 2009).

Tri dimensionet e hapjes mund të bashkëjetojnë në çdo kohë të caktuar ose mund të vendosen sipas situatës dhe mundësive aktuale arsimore.

KAPITULLI 3 – SHQYRTIMI I LITERATURËS

3.1. Përdorimi i MOOC në arsim dhe efektet e tij

Siç përmendëm më lart, MOOC janë platformë e re e të mësuarit në distancë duke përdorur mjete teknologjike të avancuara. MOOC në fillim ofroheshin falas nga shumë universitete prestigjioze të SHBA. Për shembull në vitin 2011 Sebastian Thrun së bashku me profesorë të tjerë, kolegë të tij në Universitetin e Stanfordit, SHBA, ofruan një kurs akademik falas mbi inteligjencën artificiale për të siguruar një mundësi arsimore për këdo që kishte interesim për të fituar njohuri shtesë mbi inteligjencën artificiale. Kishte pasur një jehonë të madhe ku mbi njëqind e gjashtëdhjetë mijë pjesëmarrës nga 190 vende ishin regjistruar në atë kurs. Mandej, sipas Waldrop (2013) në më pak se dy vjet, 328 kurse të hapura elektronike u nisën nga 62 institucione arsimore, duke regjistruar 2.9 milionë studentë nga 220 vende. Ky interesim i madh dëshmoi se MOOC është i arritshëm për të gjithë ata që duan të zgjerojnë dijet dhe aftësitë e tyre. Materialet që MOOC përdornin dhe që akoma përdorin janë të karakterit arsimor (me tekste të ndryshme, tinguj dhe video). Ato po ashtu përdorin edhe faqet e rrjeteve sociale siç janë Twitter, Facebook dhe Blog për të shkëmbyer përvoja dhe për të mësuar me të tjerët dhe nga të tjerët. Ky mësim bashkëpunues dallon MOOC nga platformat e tjera arsimore. Mund të ofrojë një përvojë më pjesëmarrëse dhe më ndërvepruese sesa mjetet e tjera (Waldrop, 2013).

Nga gjithë ajo që MOOC mundësuan me ofertat e tyre për kurse të hapura dhe gjithëpërfshirëse, sjell deri tek një konstatim që arsimi në dekadën e ardhshme do të pësojë ndryshime rrënjësore dhe atë në veçanti arsimi i lartë si rezultat i teknologjive më të avancuara. Deri tash, MOOC janë ofruar nëpër kampuse universitare të ndryshme, ndërsa tani e tutje parashihet që MOOC të mundësojnë zgjerimin e ofertës programore jashtë kampuseve universitare. MOOC janë dëshmuar se mund të ndihmojnë universitetet me relativisht pak përpjekje dhe fitime potencialisht të mëdha. Por, qëllimi tjetër i themeluesve të MOOC është reforma më thelbësore në mësimdhënien brenda kampusit që do të ju sjellin përfitime universiteteve. Megjithatë, përfitimet reale në produktivitetin dhe efektivitetin e të mësuarit nuk do të vijnë derisa universitetet nuk do të rimodelojnë

rrënjësisht strukturat dhe praktikat për të përfituar plotësisht nga teknologjia. Askush nuk e di saktësisht se ku mund të përfundojë ky ristrukturim, por sipas Mitchell Stevens, një sociolog në Universitetin e Stanfordit, dhe udhëheqës i një projekti të quajtur 'E ardhmja Dixhitale e Arsimit', revolucioni tashmë ka filluar. Sipas tij, universitete të mëdha si Universiteti Stanford po marrin drejtimin, "duke u përpjekur të integrojnë dhe futin të mësuarit dixhital në strukturën universitare." Ai po ashtu thekson se universitetet duhet urgjentisht të bëjnë përpjekje që të zotërojnë teknologjinë e re, para se teknologjia t'i zotërojë ato (Waldrop, 2013; Alhazzani, N, 2020).

Sipas shumë hulumtimeve të bëra Waldrop (2013), Karnouskos, S. & Holmlund, M. (2014), dhe Ingolfssdottir (2014) ndikimi i MOOC është i madh dhe do të jenë konkurrencë e vërtetë e universiteteve që do të mbajnë ligjëratat me prezencë fizike në kampuset e tyre universitare. Sipas një përlllogaritje, bota do të duhet të ndërtojë më shumë se katër universitete të reja për të akomoduar mbi 30,000 studentë në javë deri në vitin 2025¹², e lëre më miliona të rritur që do të kërkojnë arsim të mëtejshëm ose trajnim në karrierë. E vetmja mënyrë për të servisuar të gjithë këta është platforma e hapur arsimore që ofrojnë MOOC. Kolegjet dhe universitetet janë gjithashtu nën një presion të jashtëzakonshëm financiar, veçanërisht në SHBA, por jo vetëm, ku tarifat e shkollimit dhe borxhi i vazhdueshëm i studentëve kanë nxitur reagime të ashpra të politikanëve, prindërve dhe studentëve që kërkojnë të dinë se pse janë tarifat e studimeve të larta dhe se ku po mbarojnë paratë e tyre (Waldrop, 2013; Karnouskos, S & Holmlund, M, 2014; Ingolfssdottir, 2014).

Më tutje, shqyrtimi i literaturës nxjerrë në pah edhe faktin që përhapja e MOOC në botë ndikon dukshëm edhe në cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxëniet për një audiencë të gjerë. Si pasojë, universitetet synojnë të tërheqin dhe kontribuojnë në ndërgjegjësimin, përvojën dhe aspiratat ndërkombëtare të studentëve dhe të profesorëve dhe të zhvillojnë një kurrikulë të ndërkombëtarizuar. Që do të thotë se, përhapja e MOOC në botë paraqet një potencial ndryshimi në botën e arsimit në veçanti atij të lartë (Marguerite, 2012).

Si universitetet në shtetet në zhvillim po ashtu edhe bizneset veç më kanë filluar të njohin MOOC si mundësi për zhvillim profesional dhe arsimim të mëtejshëm. MOOC në të

¹²shih go.nature.com/mjuzhu

ardhmen mund të rrezikojnë edhe funksionimin e universiteteve lokale pasi MOOC veç më kanë filluar të ofrojnë edhe certifikata apo edhe diploma të përfundimit të studimeve deridiplomike apo master nga universitetet prestigjioze botërore dhe kjo paraqet një konkurrencë të theksuar duke pasur parasysh se këto diploma vijnë nga universitete prestigjioze botërore. Oferta e tillë e MOOC që u mundëson studentëve të studiojnë nga shtëpia dhe të marrin diploma cilësore, mund të ndikojë dukshëm në rritjen e numrit të atyre që do të preferonin të studiojnë në universitete prestigjioze para atyre të klasës më të ulët. Shumë studentë nga e gjithë bota mund të mendojnë se është më mirë të qëndrojnë në shtëpi dhe të marrin një MOOC sesa të shpenzojnë mijëra dollarë për të ndjekur studimet me prezencë fizike në ndonjë universitet lokal apo qoftë edhe ndërkombëtar (Marguerite, 2012). Sipas Marguerite (2012) Fondacioni Bill & Melinda Gates po shqyrton potencialin e ofrimit të MOOC për studentët me të ardhura të ulëta. Sipas Marguerite (2012) MOOC shtrijnë ndikimin e tyre edhe në (1) Agjencitë e akreditimit; (2) Botuesit e librave; (3) Subvencionet federale dhe shtetërore; (4) Agjencitë e vlerësimit; (5) Provimet e Vendosjes së Avancuar; (6) Menaxherët e regjistrimit dhe mbajtjes; (7) Kampuset e degëve universitare; (8) Këshilltarët e karrierës; (9) Zyrtarët kryesorë financiarë; (10) Menaxherët e objekteve; (11) Menaxherët e IT-së; (12) Studentët; (13) Fakulteti; (14) Kapitalistët sipërmarrës; dhe (15) Shkolla fitimprurëse (Marguerite, 2012). Sidoqoftë, edhe përkundër konkurrencës dhe rrezikimit të funksionimit normal të universiteteve lokale, Marguerite (2012) konkludon se MOOC nuk do të mund të zëvendësojë kolegjet dhe universitetet, por ato do të plotësojnë arsimin e lartë tradicional. Ata kanë potencialin për të zgjidhur disa nga problemet e mëdha me të cilat përballlet arsimi i lartë aktualisht, për të përfshirë kostot e paqëndrueshme, borxhin e studentëve të pakontrollueshëm, normat e pjesëmarrjes në kolegje, normat e pandryshuara të mbajtjes dhe diplomimit dhe konkurrencën e ashpër nga vendet e tjera. Dhe për këto arsye, 'të mësuarit në internet, të mësuarit hibrid dhe MOOC duhet të mbështeten nga komuniteti i arsimit të lartë, nga zyrtarë federalë dhe shtetërorë dhe nga agjencitë e akreditimit' (Marguerite, 2012).

Dhe në fund, sa i përket ndikimit të MOOC në arsim në vendet më të varfra apo ato në zhvillim mund të themi se krijimi i MOOC është ndërlidhur ngushtë edhe me plotësimin e nevojës për masivizimin e arsimit në zonat e goditura nga varfëria dhe në përgjithësi kanë ndikim pozitiv në arsim duke kontribuar dukshëm në ngritjen e cilësisë së arsimit në botë.

Sidoqoftë, edhe përkundër kësaj shtrirje masovike të ndikimit pozitiv, ka shumë vende në zhvillim që nuk e kanë të zhvilluar infrastrukturën teknologjike dhe këtu MOOC nuk mund të bëjnë shumë punë. Por, në vende ku teknologjia është e zhvilluar është jetike për universitetet dhe institucionet e tjera të përqafojnë mundësitë e reja që MOOC mundësojnë për performancë më të mirë akademike të institucioneve arsimore, në të mirë të studentëve dhe shoqërisë në tërësi (Ingolfsdottir, 2014). ‘Një epokë e re në arsim ka filluar dhe qëllimi ynë i përbashkët duhet të jetë vazhdimi i përpjekjes për të lehtësuar qasjen në dije të reja dhe transformim të mjediseve arsimore duke përdorur teknologjinë në mënyrën më të frytshme të mundur’ (Ingolfsdottir, 2014).

3.2. Përparësitë dhe mangësitë e MOOC-ave

Nga shqyrtimi i literaturës që trajton MOOC, mund të shohim se ekzistojnë më tepër lloje të MOOC por ne do të veçojmë dy lloje (Mehta, 2020):

1. **cMOOC** – Konektiviste – Materiali mësimor zhvillohet bashkërisht mes studentëve dhe mësimdhënësve. Ky është modeli që u sugjerua fillimisht nga Downes dhe Siemens (Downes, 2008). Struktura e kursit varet nga parimet e Konektivizmit si udhëzues për pedagogjinë e saj (AlDahdouh & Osório, 2016);
2. **xMOOC** – Të zgjeruara – Kursi posedon një strukturë të specifikuar sipas të cilës kursi duhet të mbarojë. Pra, në fund përdoruesi pasi të ketë ndjekur ligjëratat dhe të ketë kaluar provimet ka opsion të marrë certifikatë. Ekziston një kosto që lidhet me marrjen e certifikatave dhe materialeve për këto kurse. Ndryshe nga rasti i cMOOC, bashkëpunimi i studentëve me mësimdhënësit në kurse të tilla është mjaft i kufizuar, thjesht nuk ka interaktivitet dhe kontakt mes studentit dhe mësimdhënësit dhe prandaj studenti nuk mund të bëjë as pyetje e as të kërkojë ndihmë. Përmbajtja e kursit përbëhet kryesisht nga video të shkurtra, lidhje me burime të lidhura, kuize të shkurtër, pyetje me zgjedhje të shumëfishtë, projekte dhe forume diskutimi (Bali, 2014).

Sipas Mehta (2020) dhe Srikanth (2020) MOOC kanë disa përparësi, por normal si çdo gjë tjetër kanë edhe mangësi. Në vijim do të radhisim disa nga përparësitë që Mehta (2020) dhe Srikanth (2020) i përmendin, siç janë:

- Qasja është e mundur edhe nëpërmjet ndonjë miku përmes një faqe në internet.
- Regjistrimi dhe ndjekja e kursit është falas;
- Materiali përzgjidhet dhe ligjërohet nga profesorë të universiteteve më të mira në botë (normal nga ata profesorë që ofrojnë kurse);
- Ligjëratat mund të ndiqen në gjuhë të ndryshme të botës (pra me përkthim me titra në gjuhën e studentit);
- Ofrohen kurse të gjuhëve të huaja dhe studentët mund të përgatiten për teste ndërkombëtare të gjuhëve të huaja;
- Regjistrimi është i hapur për të gjithë. Po ashtu, MOOC ofrojnë lëndë të cilat nuk ofrohen nga universitetet ose universitetet i ofrojnë ato në termine kur studenti nuk mund të ndjek ligjëratat. MOOC u ofron këtyre studentëve të marrin këto kurse shtesë sipas disponueshmërisë së studentit;
- Studentët mund të zgjedhin drejtimin apo fushën e studimit duke iu nënshtruar testeve të MOOC të specializuara për t’iu ndihmuar studentëve të përzgjedhin fushën e studimit në universitete. MOOC u kursejnë kohën dhe paratë studentëve duke iu ndihmuar të vendosin për fushën e duhur të studimeve.

Tani në vijim do të radhisim disa nga mangësitë e MOOC (Mehta, 2020; Srikanth, 2020):

- Shkalla e lartë e tërheqjes së studentëve nga MOOC. Nga hulumtimet e bëra deri tani del në pah një mangësi e madhe, e ajo është se studentët regjistrojnë ndonjë kurs në MOOC, por nuk janë të interesuar apo edhe të motivuar që të përfundojnë kursin. Mendohet se shkak për këtë është se kurset ofrohen falas dhe kjo disi nuk i motivon studentët të ndjekin kursin deri në fund. Hulumtimet e bëra nga Mehta (2020) dhe Srikanth (2020) nxjerrin në pah se vetëm 15% e studentëve të regjistruar kishin përfunduar kursin. Mandej problemi tjetër ishte regjistrimi në grup i studentëve dhe nëse njëri braktiste kursin të tjerët e bënë të njëjtën gjë. Dhe arsye

tjetër pse studentët nuk e përfundonin kursin ishte edhe mosofrimi i ndonjë kredie akademike dhe kjo perceptohej sikur ata ndiqnin kursin për kot;

- Nuk është menduar për studentët me aftësi të kufizuara. Nxënësit që kanë aftësi të kufizuara në të pamurit nuk mund të ndjekin këto lloj kursesh;
- Nuk ka mundësi që studentëve të dobët t'iu kushtohet vëmendje e veçantë nga ana e ligjëruesit;
- Nuk ka kurrfarë kriteresh për regjistrim në kurset MOOC.

Nga ana tjetër sipas një studimi të bërë nga ana e Jousef et al (2015) cMOOC ofrojnë mësim në rrjet, burime të hapura arsimore, mësim me studentin në qendër të vëmendjes, fleksibilitet, ndërsa xMOOC ofrojnë përmbajtje me cilësi të lartë, dizajn të qartë të mësimdhënies, aktivitete javore, vlerësim elektronik (Jousef et al, 2015).

Poashtu, përparësitë dhe mangësitë e MOOC pak më mirë ose pak më detajisht i ka përshkruar edhe Gaebel (2014).¹³ Sipas Gaebel (2014) MOOC krijon mundësinë për ndarjen e ideve dhe njohurive dhe gjithashtu ndihmon në përmirësimin e aftësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës duke siguruar qasje të lehtë në burimet globale. Pastaj, MOOC përmirëson marrëdhëniet ndër-kulturore pasi afrojnë profesorët dhe studentët ndërkombëtarë me bekgraunde të ndryshme etnike apo religjioze. MOOC vendos kontakte mes studentëve nga e gjithë bota. MOOC rrit të mësuarit aktiv. Kërkimet tregojnë se studentët mësojnë më shumë përmes të mësuarit aktiv (d.m.th. kur ata kanë detyra ose diskutim mbi një çështje sesa përmes dëgjimit të leksioneve). Studentët i dëgjojnë leksionet më me vëmendje nëse u është dhënë një problem ose detyrë për të zgjidhur para leksionit. Në këtë drejtim, struktura që kanë shumica e MOOC - leksione të shkurtra që alternohen me detyra dhe kuize - duket se është ideale. Sigurisht, dikush mund ta bëjë këtë edhe në klasë me prezencë fizike, por do të ishte më e vështirë të sigurohet që të gjithë studentët të marrin pjesë pasi në MOOC marrin pjesë studentë nga e gjithë bota. Disa mund të kenë nevojë më shumë për të përvetësuar përmbajtjen e leksionit dhe të preferojnë ta dëgjojnë atë përsëri para se të bëjnë ndonjë detyrë apo test. Kontakti mes kolegëve i lehtësuar nga MOOC gjithashtu mund të ndihmojë në krijimin e mësimi efektiv aktiv. Ndarja e njohurive në Forumin e Diskutimit ndihmon studentët të reflektojnë së bashku me studentë të tjerë aktivë dhe vijues.

¹³<http://www.igniteengineers.com/mooc-advantages-and-disadvantages/>

Studentët që janë më të mbyllur apo introvert mund të postojnë mendimet në forum diskutimi dhe të marrin pikëpamjet e të tjerëve. Vlerësimi nga ana e shokëve apo shoqeve (kolegëve) siguron mundësinë për të mësuar përmes vlerësimit të të tjerëve, sepse është mënyra më e mirë për të mësuar kur dija dhe vlerësimi është i ndërsjellë mes kolegëve. MOOC ofron mundësinë për të mësuar nga universitete të klasit botëror dhe nga profesorë të njohur pa qenë student i universitetit përkatës, ndërsa rri ulur në shtëpi apo zyre në çdo cep të botës. Ka mundësi për të fituar certifikatat e verifikuara me logon e universitetit dhe nënshkrimin e profesorit-ligjëruesit pasi të kenë paguar për certifikatën.¹⁴ Çdokush mund t'i tregojë këto certifikata në kohën e aplikimeve për punë nëpër kompani apo institucione shtetërore nëpër gjitha vendet e botës, gjithashtu. Punëdhënësi mund të shkojë në bazën e të dhënave përkatëse të ofruesit të MOOC për të marrë informacionin në lidhje me kandidatin. Disa universitete gjithashtu filluan të lejojnë të përmbushin kërkesat për kredi të një diplome nga kurset MOOC.¹⁵ MOOC ofrojnë kurse "pa ethe provimesh" dhe inkurajojnë qasjen e thellë të të mësuarit kundrejt qasjes sipërfaqësore dhe strategjike të të mësuarit (Gaebel, 2014).

Gaebel (2014) po ashtu identifikon edhe mangësitë e MOOC edhe atë duke nisur nga videot që tërheqin studentët që të shikojnë të gjitha përnjëherë duke mos u lënë studentëve hapësirë kohore disa ditore apo javore që të shikojnë ato gradualisht që të mësojnë hap pas hapi për të kuptuar konceptet thellësisht. Pra, videot janë të gjitha të vendosura në platformë dhe studentët mund t'i shikojnë ato përnjëherë. Pastaj, përgjigja e pyetjeve në kohë reale gjithashtu nuk është e mundur gjatë ndjekjes së leksioneve. Kurset teknike që kanë nevojë për ekspozime fizike praktike (p.sh. civile, mekanike, elektrike etj.) janë mjaft të vështira për t'u ofruar përmes MOOC. Nuk ka asnjë mundësi për metoda efektive të vlerësimit, si pyetjet dhe përgjigjet në klasë, kuize të papritura dhe prezantime. Vlerësimi i kolegëve ndonjëherë çon në dekurajim mes studentëve që i çon ata në braktisjen e kursit. Stili i arsimit MOOC gradualisht do të ulë nivelin e kujdesit, ndjeshmërisë dhe respektin që ka qenë dhe aktualisht është prezent midis profesorëve dhe studentëve gjatë

¹⁴Certifikatat mund të merren me pagesë por edhe pa pagesë po që se ka ndonjë marrëveshje bilaterale mes ndonjë institucioni dhe platformës që mundëson MOOC. P.sh UEJL ka marrëveshje me Coursera prandaj certifikatat për stafin e UEJL janë falas.

¹⁵Çështja e kredive nga platformat.

mësimdhënies dhe nxënies me prezencë fizike. MOOC rrisin ndërveprimin dhe shoqërinë virtuale (Gaebel, 2014).

Në vazhdim mund të numërojmë edhe disa nga përparësitë që MOOC kanë:

1. MOOC afrojnë universitetet më të mira të botës në shtëpitë e gjithsecilit. Deri dje me siguri shumë studentë kanë ëndërruar të studiojnë në Harvard apo MIT apo Yale apo Cambridge e shumë universitete të tjera që janë në top listën e universiteteve më të mira në botë dhe tani ajo ëndërr po iu realizohet. Dyert e këtyre universiteteve po hapen për të gjithë, që gjithsecili të shijojë dijen që deri dje ka qenë e pakapur për shumë studentë të cilët nuk ka pasur gjasa që të shkojnë në ato shtete dhe të ndjekin ligjëratat në këto universitete;
2. MOOC i kombinon të dyja ligjëratat, me anë të videove që mund të rishikohen sa herë që studentët kanë nevojë të rishikojnë derisa sa ta kuptojnë materien, me studim rastesh, që u ndihmon studentëve të zhvillojnë të menduarit kritik edhe kreativ;
3. MOOC u ofrojnë të gjithë atyre të punësuarve nëpër kompani të ndryshme biznesi apo institucione shtetërore dhe që duan të japin vlerë të shtuar në vendin e punës apo të japin ndonjë kontribut të veçantë ta bëjnë atë duke u ofruar kurse të ndryshme specializimi nga universitetet më të njohura botërore.

Ndërsa si mangësi mund të përmendim dy mangësi, si për shembull:

1. Mos pasjen e kontaktit fizik apo edhe online por në kohë reale mes profesorëve dhe studentëve është shumë dekurajuese dhe demotivuese pasi gjatë ligjëratës edhe në rast se studenti nuk ka diçka të qartë dhe dëshiron të pyes për detaje nuk mundet dhe kjo mundëson krijimin e zbrazëtirave në rezultatet e të mësuarit. prandaj edhe shumica e studentëve vendosin të lenë këto kurse pa i mbaruar ato;
2. Mandej, gjatë vlerësimit mes studentëve (peer evaluation) studenti mund të bie në kontakt me studentë që nuk janë të nivelit të njëjtë të dijes dhe në këtë rast nuk mund të marrë ndonjë informatë kthyesë të përdorshme apo të mësojë diçka nga ai vlerësim apo edhe vlerësimin të mos e ketë të mirë, gjegjësisht ashtu siç duhet;

Si përfundim mund të konstatojmë se MOOC pa diskutim që janë një vlerë e shtuar e arsimimit si atij klasik po ashtu edhe atij gjatë tërë jetës. MOOC duke qenë të hapur globalisht thyjnë barrierat etniko religjioze duke e bërë botën një fshat të vogël dhe duke përafruar të gjitha kombësitë në një platformë dhe duke u ofruar atyre që së bashku të gjithë të përvetësojnë dije dhe shkathtësi që me siguri nuk do i hasnin apo nuk do i gjenin në vendet ku ata jetojnë dhe me siguri jo në formatin që mund ta gjejnë në platformat që ofrojnë MOOC si Coursera ose Udacity apo edhe platforma të tjera.

3.3. Trendi i përdorimit të MOOC në botë dhe rajon

Në këtë nën kapitull do të shqyrtojmë trendin e përdorimit të MOOC në botë dhe rajon duke përdorur të dhëna nga hulumtimet e bëra në SHBA, BE, si dhe nga të dhëna që kanë të bëjnë me MOOC në rajonin e Ballkanit si dhe nga hulumtimet që ne vetë i kemi realizuar.

MOOC, kurse masive të hapura në internet, aktualisht ofrohen në një mori lëndësh dhe gjuhësh. Ato janë krijuar nga bashkëpunime midis universiteteve, profesorëve dhe instruktorëve individualë, dhe platformave të prodhimit (Coursera, edX, etj.).¹⁶ Ndërsa shumica e kurseve burojnë nga universitetet dhe platformat amerikane, anëtarët që mendojnë përpara në sferën arsimore të Evropës po planifikojnë dhe prodhojnë gjithnjë e më shumë MOOC.¹⁷

Konsiderojmë se është me rëndësi të theksojmë se MOOC nuk kanë origjinën në Evropë ose SHBA por janë shpikur në Kanada në vitin 2008. Pesë vitet e fundit kanë sjellë një rritje dhe institucionalizim të jashtëzakonshëm për MOOC-të, të cilat u përhapën për herë të parë në universitetet partnere në Massachusetts dhe California, përfshirë MIT, Harvard dhe Stanford. Më pas MOOC lëshoi rrënjë në të gjithë SHBA. dhe Evropë, duke përfaqësuar një zhvillim të rëndësishëm që kur mësimi i asistuar nga kompjuteri filloi në vitin 1960. Sot, ka MOOC të ofruara në shumë gjuhë, duke përfshirë rusisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht, me shumicën e këtyre kurseve që vijnë nga vendet evropiane (Meixler, 2013).

¹⁶https://en.wikipedia.org/wiki/List_of_MOOC_providers

¹⁷<https://iversity.org/blog/english-moocs-in-europe/>

Sa i përket numrit të përgjithshëm të MOOC në botë tani në vitin e saj të 9-të, lëvizja moderne MOOC ka kapërcyer 180 milionë studentë, duke përjashtuar Kinën. Në vitin 2020, ofruesit e MOOC filluan mbi 2800 kurse, 19 programe studimore në internet dhe si 360 mikrokredenciale.

Më poshtë do të japim ca të dhëna që pasqyrojnë ofertën e përgjithshme të MOOC në botë deri në vitin 2020:¹⁸

Tabela 1. Ofruesit kryesorë të MOOC për sa i përket përdoruesve dhe ofertave

	<u>Nxënës</u>	<u>Kurse</u>	<u>Mikrokredenciale</u>	<u>Programe Studimore</u>
<u>Coursera</u>	76 milionë	4.6003	610	25
<u>edX</u>	35 milionë	3.100	385	13
<u>FutureLearn</u>	2,414 milionë	1,160	86	28
<u>Swayam</u>	2,16 milionë	1,130	0	0

Në vitet që çuan në vitin 2020, rritja e ofruesve të MOOC kishte ngecur. Ata po fitonin një numër të ngjashëm të studentëve çdo vit. Por në vitin 2020, ofruesit fituan mbi 60 milionë studentë të rinj së bashku. Gjysma e këtyre ishte vetëm për Coursera, i cili fitoi pothuajse po aq përdorues në një vit sesa edX, konkurrenti i tij më i afërt, që nga fillimi i tij. Në tabelë në kolonën e mikrokredencialeve janë paraqitur edhe numri i certifikimeve që mbulojnë me tepër se një kurs te vetëm por janë me pak se një nivel studimi.

Më poshtë do të nxjerrim në pah numrin e programeve studimore online për 4 vite edhe atë nga viti 2017 deri 2020:¹⁹

Tabela 2. Programet studimore online

	2017	2018	2019	2020
Coursera	4	11	16	25
edX	1	9	10	13
FutureLearn	4	18	23	28

Në total, tani ka 67 programe studimore të bazuar në MOOC përfshirë këtu edhe Master online të Georgia Tech në shkencat kompjuterike (OMSCS), që atëkohë ofrohej në Udacity.

¹⁸<https://www.classcentral.com/report/mooc-stats-2020/>

¹⁹<https://www.classcentral.com/report/mooc-stats-2020/>

Sa i përket programeve studimore ato filluan të ofrohen nëntë vjet më parë edhe atë në partneritet me universitetet. Programi i parë studimor i bazuar në MOOC, Masteri Shkencor Online në Shkencat Kompjuterike (OMSCS) nga Georgia Tech u bë përmes Udacity në vitin 2013. Ndërsa i dyti ishte iMBA nga Universiteti i Illinois edhe atë përmes Coursera në vitin 2015. Nga fillimi i vitit 2017 të paktën 9 programe studimore master ishin në dispozicion përmes platformave MOOC. Pastaj në vitin 2018 gjërat morën hov dhe tani në mes të vitit 2021 nuk ka më pak se 70 programe studimore që studentët mund të ndjekin në internet përmes një platforme MOOC.²⁰

Më poshtë mund të shihen edhe Mikrocredencialet:²¹

Tabela 3. Mikrocredencialet

<u>Lloji</u>	<u>Ofertuesi</u>	2018	2019	2020
Specializime	Coursera	310	400	569
Certifikata profesionale	Coursera	0	13	26
Master	Coursera	3	6	18
Certifikata profesionale	edX	89	123	176
MicroMastera	edX	51	56	67
Seritë X	edX	29	40	40
Arsimi profesional	edX	62	73	94
Programe deridiplomike Mikro	edX	0	0	8
Nano programe studimore	Udacity	35	40	73
Programe	FutureLearn	23	32	36
Mikrocredenciale	FutureLearn	0	0	32
Certifikata akademike	FutureLearn	14	17	19
Programe	Kadenze	19	20	20

Në vitin 2020 një e treta e studentëve u regjistruan në një platformë MOOC. Pandemia e koronavirusit detyroi shumë nga ata të kërkojnë mundësi arsimi në internet. Në veçanti, ofruesit e MOOC, përfituan jashtëzakonisht shumë duke tërhequr shumë studentë në kurset e tyre online dhe falas që ofroheshin nga universitetet më prestigjioze botërore.

²⁰<https://www.classcentral.com/report/mooc-based-masters-degree/>

²¹<https://www.classcentral.com/report/mooc-stats-2020/>

Sa i përket arsyeve kryesore për përhapjen dhe ofertën e MOOC në SHBA në veçanti tek universitetet më prestigjioze amerikane të cilët edhe janë adoptuesit më të hershëm të MOOC, disa autorë amerikanë konsiderojnë kryesisht xMOOCsat si një mjet i fuqishëm global i marketingut (Allen & Seaman, 2014).²² Sipas një hulumtimi të bërë nga Allen & Seaman (2014) për të mësuarit online në Shtetet e Bashkuara arsyeja për përhapjen e MOOC në SHBA është fleksibiliteti dhe hapja që MOOC i mundëson arsimit të lartë, pastaj arsyet e marketingut siç janë vizibiliteti i institucionit dhe tërheqja e studentëve.

Fenomeni MOOC ekziston edhe në vendet e Evropës, por sa i përket Evropës në përgjithësi pranohet që Evropa ishte shumë më e ngadaltë se SHBA në përqafimin e potencialit të MOOC, edhe pse niveli i interesit u rrit shpejt gjatë kësaj vale të dytë, me fillimin e OpenUpEd portal dhe disa projekte të financuara nga Evropa (p.sh. EMMA, HOME, MOONLITE & SCORE2020), së bashku me profilin në rritje dhe zhvillimi i platformës FutureLearn me seli në Britaninë e Madhe.

Në vijim, do të japim një pasqyrë më të detajuar rreth çështjes së ofertave të MOOC nga institucione të ndryshme të shteteve të ndryshme të Unionit Evropian të bazuara në një meta analizë të rezultateve të një hulumtimi të bërë nga Gaebel et al (2021).²³ Raporti i dalë nga hulumtimi, i cili do të shqyrtohet për të nxjerrë të dhëna për nevojën e këtij punimi të magjistraturës që trajton pikërisht MOOC, përshkruan situatën në lidhje me mësimin digjital, gjegjësisht mësimin nga distanca, dhe mësimdhënien digjitale (DELTA), gjegjësisht ligjërimit nga distanca, në institucionet evropiane të arsimit të lartë. Raporti bazohet kryesisht në të dhëna nga një anketë të kryer ndërmjet muajit prill dhe qershor 2020 përmes një pyetësoi në internet për udhëheqjen institucionale. Përveç disa pyetjeve mbi ndikimin e Krizës Covid-19, të anketuarve u është kërkuar të raportonin situata para prillit 2020, pra para pandemisë.

Sipas këtij raporti të dalë nga hulumtimi i bërë nga Gaebel et al (2021), vetëm pak më pak se gjysma e institucioneve të arsimit të lartë raportuan se ofrojnë një formë të të

²² https://www.openuped.eu/images/Publications/The_2018_OpenupEd_trend_report_on_MOOCs.pdf

²³ Gaebel, M., Zhang, T., Stoeber, H. & Morrisroe, A. (2021). Digitally enhanced learning and teaching in European higher education institutions. European University Association abs. The DIGI-HE project is co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union. This publication reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein. The report is one of the main deliverables of DIGI-HE, an EUA-led Erasmus+ project (January 2020 to December 2022) aiming to enhance universities' digitally enhanced learning and teaching strategies through self-reflection and peer learning.

mësuarit të hapur, pra diku 48%, përfshirë MOOC me 36%.²⁴ Midis atyre që deklaruan se nuk kanë asnjë ofertë aktuale për mësim të hapur, 21% synojnë të ofrojnë MOOC në të ardhmen, ndërsa dhe një numër i vogël, rreth 4% deklaruan se i ndërprejnë ato. Ngjashëm me studimet nga distanca ose nëpërmjet internetit, një numër i madh i MOOC u ofruan nga vetëm disa institucione, pra një numër i vogël i institucioneve të arsimit të lartë, ose më saktë 17% të institucioneve ofruan më shumë se 10 MOOC, ndërsa 44% të institucioneve ofruan më pak se 10.²⁵

Disa vjet më parë, MOOC ngritën mjaft debat mbi të ardhmen e arsimit të lartë. Përderisa ndikimi transformues i tyre mund të ketë qenë më pak radikal sesa supozohej në atë kohë. Ato arritën të krijojnë vendin e dytë në përdorimin e tyre pas kurseve të shkurtra dhe para disa programeve studimore online.

Nga të dhënat që sigurojnë komente individuale të të anketuarve mund të mësohet se pse MOOC nuk ofrohen shpesh e ajo është që MOOC kërkojnë një kohë të konsiderueshme dhe fonde për t'u zbatuar. Shpesh nuk janë pjesë e institucionit ose strategjia e universitetit, por më tepër zbatohet në iniciativa individuale të profesoriatit apo edhe të studentëve.

Nga institucionet që ofruan MOOC ose forma të tjera të të mësuarit të hapur, 61% gjithashtu i njohin MOOC. Kjo është një rritje e konsiderueshme krahasuar me 2014, kur vetëm 12% e mostrës ofroi MOOC dhe rreth vetëm një e treta e këtyre kredive u akordua për MOOC.²⁶

Por në vitin 2020 pranohen vetëm kurse nën kushte specifike (41%) ose të kufizuara në kurse alternative (14%). Kufizimet apo njohjet e MOOC mund të kenë arsye të ndryshme, ose brenda institucionit ku disa i njohën vetëm MOOC të veta dhe vetëm brenda programeve të caktuara, ose pengesa të jashtme siç janë ato ligjore (Gaebel et al, 2021).

²⁴Krahasimi me rezultatet e një studimi të ngjashëm të kryer nga Shoqata e Universiteteve Evropiane (EUA) në 2014, lejon të vlerësohet ndryshimin dhe ofron disa të dhëna të studiuara për një kohë të gjatë. Përgjigjet u morën nga 368 institucione të arsimit sipëror - në atë kohë - të gjitha 48 vende të Zonës së Arsimit Sipëror Evropian (EHEA). Raporti është një rezultat i projektit të bashkëfinancuar Erasmus + DIGI-HE (janar 2020-dhjetor) 2022), kryer nga EUA në partneritet me Dublin Universiteti i Qytetit (Irlandë), Baden-Wuerttemberg Universiteti Shtetëror i Bashkëpunimit (Gjermani), Vytautas Universiteti Magnus (Lituani) dhe Universiteti i Jyväskylä (Finlandë). Projekti synon të mbështesë universitetet për të zhvilluar qasje strategjike drejt DELT.

²⁵Të dhëna bazuar në përgjigjet nga një nëngrup i 228 institucioneve të arsimit të lartë.

²⁶MOOC në 2014 akoma ishin kurse të reja dhe jo shumë të njohura ndërkombëtarisht.

Raporti po ashtu bën një krahasim të rezultateve të dala në vitin 2020 me ato të vitit 2014 dhe krahasimi nxjerrë në pah faktin që në vitin 2020 motivimi për të siguruar MOOC nuk ka ndryshuar ndjeshëm, edhe atë duke rritur vizibilitetin dhe reputacionin ndërkombëtar (78%) dhe zhvillimin e mësimit inovativ dhe metodat e mësimdhënies (56%) janë konfirmuar qartë ndër tri motivacionet kryesore. “Arritja në grupe të reja të studentëve” (49%), tani është renditur i treti, më parë renditej vetëm i pesti dhe duke zëvendësuar "Rritja e rekrutimit dhe para-përzgjedhjes së studentëve". Institucioneve mund t'u duhet kohë për të eksploruar se si saktësisht mund të përdoren MOOC. Përgjithësisht është rritur ndërgjegjësimi dhe prioritizimi për qasje, përfshirje, dhe diversifikim të pjesëmarrjes, por edhe rëndësia në rritje e misionit të tretë, shërbimeve për shoqërinë, mund të ketë luajtur një rol. Në përgjithësi, përgjigjet sugjerojnë që institucionet të përdorin MOOC për më tepër qëllime të ndryshme, gjë që i konfirmon ato si formë e gjithanshme të ofrimit të tyre (Gaebel et al, 2021).

Në raport po ashtu sqarohet se nga legjislacioni i vendeve të ndryshme mund të shihet se pse "plotësimi ose zëvendësimi i mësimdhënies me prezencë fizike" nuk u shfaq në mesin e tri motiveve më të mira për të ofruar MOOC dhe programe të hapura të të mësuarit. Disa sisteme shtetërore (jurisprudenca e atyre shteteve) kufizojnë përdorimin e mësimit online, jashtë kampusit si pjesë e programeve studimore, ose kërkojnë akreditim të veçantë për të. Në disa vende, institucionet nuk mund të kërkojnë nga studentët e tyre për të ndjekur MOOC që ata ofrojnë e jo më për kurse nga platforma jashtë vendit. Kjo zakonisht ndodh në SHBA edhe atë për arsye të mbrojtjes së të dhënave. Pavarësisht reputacionit të mirë që kanë platformat për mësim nga distanca (të mësuarit nëpërmjet internetit) këto nuk ofrohen aq lehtë e jo në veçanti automatikisht pa kufij (Gaebel et al, 2021).

Nga meta analiza e rezultateve të hulumtimit të bërë nga Gaebel et al (2021) mund të shohim se çdo institucion i dytë konfirmon që ofron kurse të shkurtra në internet dhe një çerek tjetër janë duke planifikuar të ofrojnë kurse online. Ndryshe nga programet studimore në internet, të cilat institucionet individuale zakonisht i ofrojnë në sasi të vogla, 38% tregojnë se ato ofrojnë më shumë se 10 kurse të shkurtra në internet, 20% mes tyre edhe më shumë se 30 kurse. Përveç kësaj, në vitin 2018, pak më shumë se gjysma e institucioneve treguan një kërkesë në rritje për të mësuar në internet kurse të cilat sigurojnë vetëm

certifikatë, por jo edhe diplomë,²⁷ e cila u konfirmua në vitin 2020 (53%). Një numër edhe më i lartë i institucioneve presin një kërkesë në rritje për kurse të shkurtra, por aq më tepër në modalitetin e përzier (65%) dhe gjithashtu përmes provizioneve konvencionale (44%).²⁸

Më tej, kurset e shkurtra janë parë nga më shumë se gjysma e institucioneve si një mënyrë fleksibël për të siguruar mësim gjatë gjithë jetës (life long learning) (55%), e cila përputhet me faktin se ata që synojnë të ofrojnë kurse të shkurtra për kryesisht studentë të pjekur dhe të rritur janë diku 80% të institucioneve.²⁹ Pothuajse pak më pak se gjysma e institucioneve njohin certifikatat që rezultojnë nga këto kurse për studime të mëtutjeshme, dhe 43% pohuan se për disa studentë këto kurse ishin alternativë për studimet e magjistraturës. Edhe pse këto kurse i referohen MOOC në UE kanë ekzistuar kurse të shkurtra që nuk janë MOOC. Kurset e shkurtra, ose "mikro-kredencialet", aktualisht gëzojnë një përparësi relativisht të lartë në Evropë dhe disa nivele të politikave kombëtare. Për shembull, Komisioni Evropian ngriti një Grupi Konsultuesish për Mikro-Kredencialet për të zhvilluar një përkufizim më të zakonshëm, gjithashtu në lidhje me ngarkesën e punës, rezultatet e të mësuarit dhe diapazoni ECTS, dhe përmirësimin e njohjes së tyre për studime të mëtutjeshme dhe punësim.

Për më shumë vlen të theksohet se shumë vende të mëdha evropiane kanë filluar të ofrojnë MOOC, ose po mendojnë ta bëjnë këtë. Në rajonin e Beneluksit, Universiteti Leiden i Holandës, Universiteti Delft, Universiteti i Amsterdemit dhe Open Universiteit kanë MOOC përkatësisht në bashkëpunim me Coursera, edX, OpenUpEd dhe Sakai. Italia gjithashtu filloi të ofrojë MOOC me OpenUpEd, dhe Universita degli Studi di Napoli Federico II ka platformën e vet MOOC. Universitete të tjera italiane kanë Coursera MOOC, dhe njëri aplikoi për konkursin e bursave të MOOC të universitetit. Universiteti i tij Bocconi ka një laborator që hulumton MOOC. Spanja gjithashtu strehon platformën e prodhimit Miriada X, e nisur në janar 2013 (Meixler, 2013).

Pastaj, sa i përket Mbretërisë së Bashkuar ajo gjithashtu ka një platformë të re MOOC, FutureLearn. Themeluar nga Universiteti i Hapur në dhjetor 2012, ai ka partneritet me 21 universitete në Mbretërinë e Bashkuar dhe Republikën e Irlandës, përfshirë King's

²⁷Për më tepër shih (Trends 2018, f. 60),

²⁸Për më tepër shihni Gaebel et al (2021, f. 23 tabela 10)

²⁹Ibid

College London dhe Trinity College Dublin, dhe institucione të shquara kulturore britanike. Universiteti i Londrës dhe Universiteti i Edinburgut kanë Coursera MOOC. Universiteti i Edinburgut është partneri i parë i platformës joamerikane. Universitetet e Mbretërisë së Bashkuar gjithashtu kanë MOOC në bashkëpunim me BlackBoard CourseSites dhe platforma të tjera, dhe interesimi për fillimin e MOOC është shfaqur kohët e fundit në Uells (Meixler, 2013).

Ndërsa, në Gjermani MOOC filluan të ofrohen në vitin 2008. Platforma Iversity u themelua në 2008 si një platformë bashkëpunimi akademik dhe u inkorporua në 2011. Iversity, i kryesuar nga Marcus Riecke dhe Hannes Klöpper filloi të ofrojë kurse që organizoheshin nga specialistë nga universitetet gjermane, italiane dhe spanjolle, përfshirë profesorin Christian Spannagel nga Universiteti i Edukimit Heidelberg. Universiteti Ludwig-Maximilians në Munihi ka një partneritet me Coursera dhe Universiteti i Frankfurtit është gjithashtu i përfshirë në iniciativë të të mësuarit në internet. Fernuniversität Hagen, universiteti i vetëm i Gjermanisë me një fokus në mësimin në distancë, filloi të eksperimentojë me MOOC në fillim të vitit 2013. Universitete të tjera përveç FernUni Hagen gjithashtu drejtojnë në mënyrë të pavarur MOOC, të tilla si Kampusi i Gjuhësisë Virtuale në Universitetin e Marburgut. Platforma të tjera gjithashtu kanë zënë rrënjë në Gjermani, të tilla si Open HPI, Open.SAP dhe Open Course World (Meixler, 2013).

Sipas Meixler (2013) OpenUpEd është një iniciativë pan-Evropiane e MOOC e mbështetur nga Komisioni Evropian ka 60 kurse falas në internet në 10 gjuhë me universitete në Francë, Britani të Madhe, Lituani, Holandë, Sllovaki dhe vendet e Evropës Jugore duke përfshirë Portugalinë, Spanjën dhe Italinë. OpenUpEd gjithashtu ka partnerë me universitete jashtë Bashkimit Evropian, duke përfshirë ato në Rusi, Turqi dhe Izrael, dhe planifikon të punojë me institucione në Qipro, Skandinavi (Danimarkë konkretisht), Estoni, Greqi, Poloni dhe Slloveni. Ekzistojnë iniciativë të tjera shumëkombëshe për të promovuar formimin e MOOC në Evropë, me bashkëpunimin midis universiteteve të EuroTech. Pastaj, MOOC ofrohet edhe në rajonin DACH, në Austri dhe Zvicër, veçanërisht me Universitetin e Teknologjisë të Vjenës dhe ETH Zurich përkatësisht. Universitetet dhe institucionet në Danimarkë, Irlandë, Portugali, Finlandë, Francë dhe Belgjikë janë gjithashtu të përfshirë në prodhimin e MOOC. Universitetet nga këto vende kanë partneritet me platforma të mëdha

si edX, Coursera ose Udacity, po ashtu kanë edhe platformat e tyre MOOC (si Universiteti i Amsterdamit), ose punojnë me platforma të tjera si Moodle (Meixler, 2013).

Nga kjo që u tha më sipër shohim se MOOC më së shumti ofrohen nga universitetet me prestigjioze amerikane dhe më pas pasojnë ato të Evropës. Ndërsa MOOC janë duke u zgjeruar në Evropë, ky ndryshim arsimor është përqendruar në Evropën Perëndimore dhe shumë vende të tilla si Greqia, Ukraina (dhe pjesa më e madhe e Evropës Lindore) dhe shtetet e Ballkanit.

Sa i përket rajonit tonë vlen të theksohet Projekti BAEKTEL, qëllimi i të cilit është vendosja e kornizës OER (Open Education Resources) apo kornizës për burime të hapura arsimore për nxitjen e mësimi të ndihmuar nga teknologjia në institucionet e arsimit të lartë dhe mësimi gjatë tërë jetës brenda kompanive në shtetet e Ballkanit Perëndimor (BAEKTEL, 2013)³⁰. Në fakt, arsimi i hapur shpesh kuptohet si burime të hapura arsimore (OER) dhe nganjëherë si të dhëna të hapura kërkimore. Kuadri, megjithatë, kërkon të promovojë një qasje më holistike për arsimin e hapur. Propozon që arsimi i hapur bashkëkohor të shkojë përtej OER dhe rezultateve të hapura të kërkimit për të përqafuar vendimet strategjike, metodat e mësimdhënies, bashkëpunimet midis individëve dhe institucioneve, njohjen e të mësuarit të hapur dhe mënyra të ndryshme të vënies në dispozicion të përmbajtjes. Arsimi bashkëkohor i hapur kryesisht mundësohet nga TIK dhe kështu, ekziston një potencial i pafund për inovacion dhe arritje (Inamorato, 2016).

Më tutje, duhet të potencojmë se edhe UNESCO në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Politike të Sarajevës do të nisin një Kurs Unik Masiv të Hapur Online (MOOC) mbi Shkencat e Medias dhe Informacionit në gjuhën e BiH dhe i lokalizuar në kontekstin kombëtar që nga fillimi i vitit 2021. Zhvillimi i një mjeti të tillë të ri, i cili do të jetë falas për përdorim është bërë i mundur përmes Projektit të financuar nga BE 'Ndërtimi i Besimit në Media në Evropën Juglindore dhe Turqi - Faza 2', i cili synon të adresojë dezinformimin në rajon dhe në këtë mënyrë forcojnë aftësitë mediale dhe informative të njerëzve në rajon.³¹

³⁰<https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/projects/eplus-project-details/#project/544482-TEMPUS-1-2013-1-IT-TEMPUS-JPHES>

³¹<https://en.unesco.org/news/unesco-will-launch-free-mil-massive-open-online-course-mooc-south-east-europe>

MOOC po ashtu ofrohen edhe në Shqipëri.³² Platforma shqiptare quhet ALMOOC. Përmes kurseve dhe ngjarjeve në ALMOOC.com, studentët mësojnë për teknologjinë informative, gjë që do t'iu mundësonte atyre të bëjnë hapa të rëndësishëm përpara në karrierën e tyre. ALMOOC.com vazhdon të ofrojë një përzgjedhje të gjerë të kurseve online falas, të tilla si Node Js, Ruby on Binarët, Java për Android si dhe do të zgjerojë gamën e saj në kurse më të avancuara. ALMOOC gjithashtu aspiron të bëhet një mjet trajnimi i përdorur nga kompanitë e teknologjisë informative për trajnimin e tyre në punë.³³

Më tej, sa i përket shteteve të Ballkanit vlen të theksohet edhe një projekt i Profesorit të Universitetit të Western Case Reserve (CWRU) Michael Goldberg, në partneritet me Ambasadën e SHBA në Maqedoninë e Veriut dhe CEFÉ Maqedoni rekrutoi një grup të veçantë të qytetarëve nga Maqedonia e Veriut për të marrë pjesë në kursin e tij Përtej Luginës Silicon. Goldberg nisi Përtej Luginës Silicon në Coursera në prill 2014 dhe ajo ka tërhequr mbi 175,000 studentë nga 190 vende gjatë 5 viteve të fundit. Përtej Luginës Silicon është përkthyer në 16 gjuhë (shumica në platformën Coursera) përfshirë maqedonishten. Goldberg vizitoi Maqedoninë e Veriut në vitin 2014 dhe 2016 me ftesë të Ambasadës Amerikane në Maqedoninë e Veriut për të drejtuar punëtori në lidhje me kursin e tij Përtej Luginës Silicon.³⁴

Më tutje, me rëndësi për t'u përmendur janë edhe kurset e hapura MOOC që Qendra Britanike në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut i ofron për qytetarët e Maqedonisë së Veriut edhe atë kurse falas.³⁵ Këto kurse kanë të bëjnë më tepër me mësimin e gjuhës angleze si dhe kurse që kanë të bëjnë me përvetësimin e aftësive për vendin e punës.

Në fund, ashtu siç përmendëm në fillim të këtij nënkapitulli do të nxjerrim në pah edhe disa nga përgjigjet e pyetësorit me studentë nga Tetova, Shkupi dhe rajoneve të tjera të Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i pyetësorit ishte të nxjerrim informata rreth asaj se sa janë studentët të informuar për MOOC në Maqedoninë e Veriut si dhe nëse ata kishin ndjekur ndonjë kurs nëpërmjet MOOC si dhe si i vlerësojnë ata MOOC duke pasur parasysh se janë platformë e re mësimdhënëse. Në total numri i të anketuarve ishte 53. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve 47.2% kishin njohuri për MOOC, ndërsa 52.8% nuk kishin

³²<https://www.mooc-list.com/course/albanian-wma>

³³<http://risialbania.al/index/wp-content/uploads/2016/05/Annual-Brief-ALMOOC-27.pdf>

³⁴<https://cefe.mk/en/opportunity-to-participate-in-free-moderated-beyond-silicon-valley-online-entrepreneurship-course/>

³⁵<https://www.britishcouncil.mk/en/english/mooc>

dëgjuar për MOOC fare. Çuditërisht një numër i madh i atyre që kishin dëgjuar për MOOC si dhe kishin ndjekur ndonjë kurs MOOC, i vlerësonin MOOC me një notë mesatare. Rreth 50% të atyre që kishin ndjekur MOOC mendonin se këto kurse janë të dobishme vetëm si pjesë e zhvillimit profesional apo si kurse shtesë për të fituar njohuri shtesë si dhe si kurse për të moshuar apo edhe për mësim gjatë gjithë jetës. Kjo do të thotë se për këta studentë MOOC nuk mund të jenë zëvendësim për studimet klasike.

Si përfundim mund të konstatojmë se MOOC kanë marrë hov të madh në botë nga Kanada, nga edhe u nisën për herë të parë, SHBA, Evropë e gjetiu nëpër botë, pra pothuajse në çdo vend të botës.

MOOC do të jenë e ardhmja e arsimit, në veçanti atij të lartë. Nga hulumtimi jonë nxorëm në pah edhe faktin që MOOC kanë një lloj tendence për t'iu konkurruar universiteteve nëpër botë, por kjo për fillim nuk është ndonjë rrezik pasi çdo shtet rregullon hapësirën arsimore me ligje interne dhe MOOC në këtë drejtim mund të jenë vetëm një vlerë e shtuar në arsimin në përgjithësi, por në arsimin e lartë dhe për zhvillim profesional në veçanti.

KAPITULLI 4 – ANALIZA DHE INTERPRETIMI I TË DHËNAVE NGA HULUMTIMI


4.1. MOOC-at dhe përdorimi i tyre në edukim

Për të studiuar ndikimin dhe përdorimin e MOOC-ave në procesin e edukimit në rajon, është realizuar një pyetësor i cili do të na jep një pasqyrë më të qartë se sa janë MOOC-at të pranishëm tek ne. Ky pyetësor njëherit do të na shërbej në vërtetimin apo anulimin e hipotezave 1 dhe 2 si dhe sa dhe për çfarë qëllimi studentët i përdorin MOOC-at.

4.1.1. Demografia e pyetësorit


Ky pyetësor siç përmendëm më lart ka të bëjë me përhapjen dhe përdorimin e MOOC-ave në vendin tonë. Pyetësori u plotësua nga 53 studentë nga të cilët 37 ishin meshkuj ndërsa 16 ishin femra.

Gjinia:
53 responses



Grafiku 1. Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë


Mosha juaj:
53 responses



Grafiku 2. Shpërndarja e të anketuarve sipas moshës

Sa i përket moshës së studentëve, pjesa dërmuese e studentëve apo 48 studentë ishin të moshës 18-21, ndërsa 5 studentë ishin të moshës 21-25 (grafiku 2).

Qyteti:
53 responses



Grafiku 3. Shpërndarja e të anketuarve sipas vendlindjes të studentëve

Siç shihet nga grafiku 3, nga gjithsejtë 53 të anketuar, 18 studentë janë nga Shkupi, 15 studentë janë nga Tetova dhe 20 studentë janë nga qytete të tjera në rajon.


Tani, në vazhdim do të mësojmë më tepër për përgjigjet që studentët i kanë dhënë në lidhje me MOOC. Në pyetjen nëse ata kishin dëgjuar për MOOC 47.2% janë përgjigjur me “Po”, ndërsa 52.8% me “Jo”. Kjo përqindje e lartë është shumë simptomatike pasi MOOC vazhdimisht po reklamohen në internet por jo vetëm.

4.1.2. Sa janë të njohur të anketuarit me MOOC-at

Në këtë pjesë paraqiten rezultatet e pyetjes: A keni dëgjuar për MOOC?

Siç shihet nga grafiku 4, 47% kanë dëgjuar, ndërsa pjesa tjetër nuk ka njohuri për to. Për dallim nga trendet botërore, në rajon shihet një shpërndarje gati gjysmë-përgjysmë e të informuarve dhe e atyre që nuk kanë fare njohuri për to.


II.1 A keni dëgjuar për MOOC-at (Massive Open Online Course)?
53 responses



Grafiku 4. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: "A keni dëgjuar për MOOC-at?"

4.1.3. Vlerësimi i MOOC-ave

II.2 Nëse keni dëgjuar si do ti vlerësoni MOOC-at ?
53 responses




Grafiku 5. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: "Nëse keni dëgjuar, si do t'i vlerësoni MOOCs-at?"

Për sa i përket pyetjes se si studentët i vlerësojnë MOOCs-at, 48% e studentëve janë përgjigjur me mesatarisht, ndërsa vetëm 7.5% e studentëve i kanë vlerësuar MOOC me shkëlqyeshëm.

4.1.4. MOOC-at dhe mundësia për mësim gjatë gjithë jetës

II.3 MOOC-at e rrisin mundësinë dhe interesin për edukim gjatë gjithë jetës.

53 responses




Grafiku 6. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “A e rrisin MOOC mundësinë dhe interesimin për arsimim gjatë gjithë jetës? (life long learning)”

Siç mund të shohim nga grafiku 6, shihet qartë se mbi 50% e studentëve konsiderojnë se MOOC përdoren më tepër si kurse shtesë që ndihmojnë në zhvillim profesional të personave që ndjekin ato. Ndërsa, 45.3% e studentëve nuk janë të sigurt se cili është qëllimi i MOOC. Kjo është kështu pasi një përqindje e ngjashme e studentëve zaten nuk kishin dëgjuar për MOOC dhe ndoshta edhe kjo është arsyeja për këtë përqindje të studentëve që janë përgjigjur me neutral.

4.1.5. MOOC-at përdoren për arsimim joformal

II.4 MOOC-at më tepër përdoren për edukim joformal se sa në shkollim formal.

53 responses




Grafiku 7. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “MOOC-at përdoren për arsimim joformal!”

Siç shihet nga grafiku 7, rreth 40% e studentëve pajtohen me deklaratën që MOOC më tepër përdoren për arsimim joformal sesa formal, por nga ana tjetër kemi një përqindje

të madhe që janë neutralë. Në këtë rast përqindja tejkalon përqindjen e studentëve që në fakt nuk kanë dëgjuar për MOOC, gjë që lë të nënkuptohet se pothuajse të gjithë studentët që në fakt kanë njohuri për MOOC pajtohen se MOOC nuk ofrojnë programe studimore por ato ofrojnë kurse për zhvillim profesional.

4.1.6. Përvoja në përdorimin e MOOC-ave

II.5 A keni mësuar ndonjëherë prej kurseve masive të hapura online (MOOC)?
53 responses



Grafiku 8. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: “A keni ndjekur ndonjë MOOC?”

Nga grafikun 8 mund të shohim se 41.5% e studentëve kanë ndjekur një MOOC që do të thotë se shumica e atyre studentëve që në fakt kishin njohuri për MOOC, ndërsa nga ata që janë përgjigjur me “Jo” del që një numër i vogël i studentëve që në fakt kanë dëgjuar për MOOC nuk kanë ndjekur ndonjë MOOC.

4.2. Gjuha dhe MOOC-at

Në këtë nënkapitull do të shohim se vallë MOOC-at mund të ofrohen edhe në gjuhët e ndryshme të botës pos gjuhës angleze që në fakt tani edhe ofrohen në shumicën e rasteve.

Siç pamë nga kapitujt e mësipërm, shumica e universiteteve, në një mënyrë apo në një tjetër, janë në biznesin e arsimit në internet. Në vitin 2018 Universiteti i Pensilvanisë u bë institucioni i parë i Ivy League që ofroi një program bachelor plotësisht online, ndërsa Universiteti Columbia nisi një MOOC për të përgatitur veteranët për të kaluar në jetën universitare. Edhe disiplinat që më tradicionale tani po mendohet të ofrohen plotësisht

online (Agudo, 2019). Mandej, më sipër u potencua fakti se kurset MOOC u ofrohen të gjitha komuniteteve në botë pa marrë parasysh etninë apo religjionin e tyre dhe se të gjithë këta studentë mësojnë së bashku në një platformë të njëjtë online. Coursera ka 181 partnerë në 27 vende dhe edX ka 130 partnerë në të gjithë botën. Përkundër arritjes së tyre ndërkombëtare, anglishtja është gjuha e mësimit për mbi 80 përqind të kurseve të tyre. Në të kundërt, anglishtja përbën rreth 50 përqind të përmbajtjes në internet, dhe anglishtfolësit 30 përqind të gjithsej përdoruesve.

Po qe se pyesim se a thua vallë mund të jenë edX dhe Coursera platforma globale dhe të jenë funksionale njëgjuhëshe pasi të dyjat ofrojnë kurse të hapura masive ekskluzivisht në gjuhën angleze, përgjigjja sigurisht do të ishte që po. Dhe kjo përgjigje do të gjente mbështetjen tek të dhënat se universitetet në Evropë, Azi dhe Amerikën Latine gjithnjë e më shumë po adoptojnë gjuhën angleze si mjet mësimi për programet online dhe ato brenda kampusit. Nëse mendojmë për arsimin e lartë si një treg global, gjuha angleze si medium mbizotërues i mësimdhënies është një zgjedhje krejtësisht logjike. Në interes të përgatitjes së të diplomuarve për një treg konkurrues global të punës, universitetet nga vendet që nuk flasin anglisht konkurrojnë për studentët duke kaluar klasat e tyre në anglisht (Agudo, 2019). Megjithatë, nëse qëllimi është sigurimi i qasjes në arsim me cilësi të lartë për numrin më të madh të njerëzve, këto platforma duhet t'i rezistojnë tërheqjes së gjuhës angleze (Agudo, 2019). Në fakt ideali i ofruesve të MOOC është të ofrohen MOOC për çdo person pa marrë parasysh ai person a e flet gjuhën angleze apo jo. Në kohën kur Coursera dhe edX debutuan në kurset e tyre të para, MOOC erdhi për të përfaqësuar një demokratizim të paparë të njohurive, një nxitje për lëvizjen sociale për nxënës të shkathët dhe të motivuar kudo, pavarësisht nga pengesat gjeografike, kulturore, gjinore ose socio-ekonomike. Ky qëllim i lavdërueshëm ende ekziston në deklaratat e misionit të edX dhe Coursera, të dyja këto synojnë t'i shërbejnë "të gjithëve, kudo" dhe "çdokujt, kudo" (Agudo, 2019). Sipas Agudo (2019) anglishtja krijon një barrierë të pabarazisë për shumë njerëz në të gjithë botën. Njohja e gjuhës angleze është një shenjë e privilegjit socio-ekonomik. Më tej, ka prova që angazhimi rritet kur nxënësit trajtojnë përmbajtjet mësimore në gjuhën e tyre amtare. Nga disa hulumtime të bëra në Brazil, kurset e ofruara në gjuhën portugeze kanë rritur pjesëmarrjen e studentëve për 50 përqind. Po ashtu hulumtimet dëshmojnë se

po qe se MOOC ofrohen në Indonezi, po qe se ato ofrohen në gjuhën amtare, do të jenë më atraktive dhe do të përfshin një audiencë më të gjerë.

Origjina e MOOC në botën anglishtfolëse ka të ngjarë të nxjerr në pah faktin që ofertat e kurseve nuk i përgjigjen preferencave të gjuhës globale. Provat dhe vëzhgimet shkencore të tyre u kanë treguar studiuesve të tjerë se ofertat e MOOC janë me të vërtetë të kufizuara në larminë gjuhësore (Castillo et al., 2015; Godwin-Jones, 2014; Straton & Grace, 2016). Sipas Straton & Grace (2016) pothuajse 80% e MOOC-ve ishin në anglisht dhe se kurset ishin në dispozicion në 13 gjuhë në kohën e shkrimit të tij (Straton & Grace, 2016).

Shumëllojshmëria gjuhësore e ofertave MOOC është një sfidë e menjëhershme për qasjen universale të MOOC dhe është ndoshta më e hollësishme për hulumtim sesa sfidat e tjera sociale për qasjen në MOOC sepse është e vëzhgueshme në infrastrukturën online të ballafaqimit të publikut të platformave MOOC (Straton & Grace, 2016).

Sipas analizës së të dhënave nga analiza statistikore e bërë nga ana e Straton & Grace (2016) del në pah se MOOC nuk janë shpërndarë në të njëjtën mënyrë për gjuhë të ndryshme të ligjëratave kur merret parasysh lënda mësimore, disponueshmëria e kursit (e planifikuar / joplanifikuar), ose mundësia për të marrë një letër kredenciale për kursin pas përfundimit të tij. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shpërndarjet e ofertave të kursit në lidhje me temën, disponueshmërinë dhe mundësitë e kredencialitetit shoqërohen me gjuhën në një nivel statistikisht të rëndësishëm. Kështu, ofertat e kurseve MOOC janë të ndryshme nga gjuha në terma absolutë (ndryshimet në sasinë e kurse) dhe termat relativë (ndryshimet në shpërndarjen e kurse në drejtim të lëndës), disponueshmërisë dhe kredencialit (Straton & Grace, 2016).

Sasia e kufizuar e MOOC-ve të ofruara në gjuhë të ndryshme nga gjuha angleze do të thotë që MOOC nuk janë të disponueshëm për çdo individ i cili do të shprehte dëshirë të ndjekë MOOC pasi inputet e aftësive për individët që nuk flasin, lexojnë, dhe shkruajnë në gjuhën angleze nuk janë me një nivel të lartë aftësie. Sigurisht, të jesh folës i gjuhës amtare që dallon nga gjuha angleze nuk përjashton mundësinë që një përdorues i mundshëm i MOOC të ketë nivelin e duhur të aftësisë në gjuhën angleze për të përdorur MOOC në gjuhën angleze; megjithatë, studimet tregojnë se individët në vendet në zhvillim nuk ka të

ngjarë të jenë shumë të aftë në gjuhën angleze (EF English Proficiency Index, 2015 në Straton & Grace, 2016), duke kufizuar përdorimin e mundshëm të MOOC për zhvillim.

Si rrjedhojë është menduar një alternativë që është përkthimi i ligjëratave nga gjuha angleze në gjuhën amtare të studentit. Përpjekjet e përkthimit kanë rezultuar me rritje në qasje në shkallë më të lartë në MOOC ekzistuese dhe ofruesit e MOOC për përdoruesit nga vendet në zhvillim ofrojnë opsione në MOOC për përkthim me titra në gjuhën e preferuar të studentit.

4.2.1. Përpunim i titrave të lëndës Python në Udacity

Për të adresuar pyetjet kërkimore që kemi vendosur në fillim të kësaj teze të magistraturës si dhe për të përdëftuar apo mohuar hipotezat, kemi përdorur metoda hulumtuese sasiore, gjegjësisht dy pyetësorë.

Inicilaisht janë marrë materialet mësimore të një lënde në Udacity. Konkretisht kursi në Python. Përcaktimi për këtë kurs është bazuar në atë se është pjesë e shumë lëndëve mësimore dhe studentët që do ta përdorin do të ishin në një numër signifikant për studim.

Për këto materiale, janë përkthyer titrat në gjuhën shqipe. Kanë qenë gjithsejtë 63 video me mbi 1839 titra.

Këto materiale pastaj janë ndarë me student që e mësojnë këtë lëndë dhe është realizuar një pyetësor që të analizohet ndikimi i gjuhës së MOOC-ave në përvetësimin dhe pranimin e këtij formati të hapur të materialeve mësimore në vende ku gjuha angleze nuk është gjuha e parë.

Pyetësorët u hartuan në atë mënyrë që marrin në konsideratë daljen në përdorim të platformave MOOC, përhapjen e tyre në rajonin tonë si dhe përdorimin e tyre nga studentët, si palë interesi apo si klient që përdorin MOOC për arsimin e tyre apo për zhvillimin e tyre profesional.


Në këtë kontekst, kemi përgatitur edhe pyetësorin për tutorialet në Python (nga Udacity) me titra në gjuhën shqipe që të anketojmë një grup të konsiderueshëm të studentëve me qëllim të mbledhjes së të dhënave që do të na ndihmojnë për të ardhur deri

në përfundime shkencore që do të na ndihmojnë t'i përgjigjemi pyetjeve hulumtuese të këtij punimi magjistrature.

4.2.2. Demografia e pyetësorit për tutorialet në Python nga Udacity


Në pyetësorin e dytë 'Pyetësor për tutorialet në Python (nga Udacity) me titra në Gjuhën Shqipe' siç përmendëm më sipër kemi anketuar një grup prej 71 studentësh. Të gjithë këta studentë studiojnë shkencat kompjuterike (CST) në UEJL. Nga 71 studentë të anketuar, 49 ishin meshkuj, ndërsa 22 femra.

Gjinia:
71 responses



Grafiku 9. Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë


Mosha juaj:
71 responses



Grafiku 10. Shpërndarja e të anketuarve sipas moshës

Sa i përket moshës së studentëve, pjesa dërmuese e studentëve, siç shihet në grafikun 10, 90% e studentëve ishin të moshës 18 deri 21 vjeç, ndërsa 9.9% ishin të moshës 21-25.

Qyteti:
71 responses




Grafiku 11. Shpërndarja e të anketuarve sipas vendlindjes të studentëve

Grafiku 11 ka të bëjë me vendlindjen e studentëve. Siç shohim rreth 30% të studentëve ishin nga Shkupi, 34% nga Tetova dhe 37% studentë janë nga qytete të tjera në rajon. Në vazhdim do të mësojmë më tepër për përgjigjet që studentët i kanë dhënë në lidhje me tutorialet në Python.

4.2.3. Sa kanë dëshirë të anketuarit të mësojnë mësimet apo kurset përmes videove


Në këtë pjesë paraqiten rezultatet e pyetjes: A dëshironi të mësoni mësimet përmes videove? Grafiku 12 tregon se rreth 81.7% e studentëve mësojnë më mirë përmes videove, ndërsa 18.3% kundërshtuan. Duke pasur parasysh se MOOC përmbajnë ligjërata të xhiruara në video ky rezultat tregon se një numër shumë i madh i studentëve do të ishin të kënaqur nga rektionet në video të MOOC si dhe do të kishin pasur rezultate të mira në të nxënit.



Grafiku 12. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: "A dëshironi të mësoni mësimet përmes videove?"

4.2.4. Tutorialet online a janë të përshtatshme për mësim joformal sesa formal


7



Grafiku 13. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: "Tutorialet Online janë më të përshtatshme për mësim joformal sesa për mësim formal?"

Në pyetjen rreth tutorialeve online, në grafikun 13 studentët janë deklaruar në numër të konsiderueshëm që këto tutoriale përdoren për mësim joformal, me siguri duke u bazuar në përvojën e tyre gjatë ndjekjes së ndonjë MOOC.


4.2.5. Cila është mënyra më e mirë e të mësuarit



Grafiku 14. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: "Sipas jush, mënyra më e lehtë e të mësuarit është?"

Përgjigjet e studentëve në pyetjen rreth mënyrës së të mësuarit nxjerrin në pah të dhëna interesante pasi pjesa dërmuese e studentëve parapëlqejnë mësimin face to face, ndërsa mësimin online vetëm 17% e studentëve e sa i përket kurseve MOOC me përkthim në gjuhën amtare të studentëve vetëm 21% i parapëlqejnë ato. Kjo do të thotë se kurset MOOC të përkthyer në gjuhën amtare të studentëve nuk janë aq tërheqës për studentët dhe se përkthimi nuk kontribuon shumë në drejtim të atraktivitetit të kurseve MOOC me përkthim.


4.2.6. Mënyra më e mirë e të mësuarit është përmes kurseve online



Grafiku 15. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: "Mënyra më e përshtatshme e të mësuarit është përmes mësimit (Kurseve Online)"

Sa i përket pyetjes rreth mënyrës së të mësuarit të studentëve gjegjësisht të mësuarit përmes MOOC-ave pjesa dërmuese e studentëve ose janë neutralë ose nuk pajtohen dhe vetëm më pak se 30% e studentëve të anketuar janë pajtuar se mund të mësojnë nëpërmjet MOOC. Këto përgjigje janë shumë indikative pasi edhe njëherë studentët me përgjigjet e tyre konfirmojnë se asnjë mënyrë tjetër pos mësimit tradicional në kampuse për ta nuk është i mirë dhe se MOOC nuk mund të zëvendësojnë mësimin tradicional në kampus, pra me prezencë fizike.

4.2.7. Kursi online me përkthim në gjuhën tuaj amtare është më i përshtatshëm




Grafiku 16. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: "Mësimi (Kurset Online) me përkthim të përshtatur në gjuhën tuaj amtare është shumë më i kuptueshëm"

Sa i përket grafikut 16 i cili ka të bëjë me përshtatshmërinë e kurseve MOOC në gjuhën amtare, shohim se studentët në një përqindje të konsiderueshme preferojnë kurse të përkthyer në gjuhën amtare. Kjo zakonisht ndodh me studentë që nuk e njohin mirë

gjuhën angleze dhe gjuha amtare në këtë rast u ndihmon për të kuptuar mësimet më mirë edhe pse kjo në të shumtën e rasteve varet edhe nga përkthimi nëse është cilësor apo jo.


4.2.8. Mënyra më e mirë e të mësuarit është face to face



Grafiku 17. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: "Mënyra më e përshtatshme e të mësuarit është face to face?"

Grafiku 17 edhe njëherë përdëfton tezën se studentët preferojnë mësimin face to face, pra me prezencë fizike. Pjesa dërmuese e studentëve rreth 66% janë përgjigjur pozitivisht, rreth 30% janë neutralë dhe shumë pak nuk pajtohen ose rreth 3% deri në 4%.

4.2.9. A ndihmojnë tutorialet me titra të përkthyer në gjuhën shqipe në përvetësimin e temës së prezantuar



Grafiku 18. Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen: "Tutorialet me titra të përkthyer në gjuhën shqipe ndihmojnë shumë në përvetësimin e temës së prezantuar."

Grafiku 18 më sipër nxjerrë në pah edhe njëherë mendimet e shumicës së studentëve që pajtohen se përkthimet e MOOC mund të ndihmojnë në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore.

KAPITULLI 5 – REZULTATET E STUDIMIT

Për të përmbledhur gjithë atë që u trajtua më sipër dhe për të nxjerrë në pah gjetjet më të rëndësishme në këtë punim magjistrature, i cili synonte të hetonte përhapjen e MOOC-ave (kurset masive të hapura në internet) në botë dhe rajon, ne do të japim përgjigje për secilën nga pyetjet kërkimore veç e veç, të cilat i vendosëm në fillim të këtij punimi të magjistraturës.

5.1. Cilat janë llojet e MOOC që përdoren në rajonin tonë?

Sa i përket rajonit tonë mund të konstatojmë se përdoren më tepër lloje të MOOC nga më tepër platforma, siç janë Coursera, Edx, Udacity, FutureLearn etj. Sa i përket rajonit tonë duhet të potencojmë Projektin BAEKTEL, që ka për qëllim vendosjen e kornizës OER (Open Education Resources) apo kornizës për burime të hapura arsimore për nxitjen e mësimi të ndihmuar nga teknologjia në institucionet e arsimit të lartë dhe mësimi gjatë tërë jetës (BAEKTEL, 2013).

Më tej, duhet theksuar bashkëpunimin e UNESCO-s me Fakultetin e Shkencave Politike të Sarajevës në Bosnje dhe Hercegovinë gjatë së cilit do të zhvillojnë një MOOC mbi Shkencat e Medias dhe Informacionit në gjuhën e BiH dhe i lokalizuar në kontekstin kombëtar që nga fillimi i vitit 2021. Zhvillimi i një mjeti të tillë të ri, i cili do të jetë falas për përdorim është bërë i mundur përmes Projektit të financuar nga BE 'Ndërtimi i Besimit në Media në Evropën Juglindore dhe Turqi - Faza 2', i cili ka për qëllim forcimin e aftësive mediale dhe informative të njerëzve në rajon.³⁶

Pastaj, duhet theksuar se edhe në Shqipëri ofrohen MOOC edhe atë me një platformë të quajtur ALMOOC që përdoret për aftësimin e studentëve për përdorimin e TIK-ut.³⁷ ALMOOC.com ofron një numër të madh të MOOC-ave falas, të tilla si Node.js, Ruby on Binarët, Java për Android etj.³⁸

³⁶<https://en.unesco.org/news/unesco-will-launch-free-mil-massive-open-online-course-mooc-south-east-europe>

³⁷<https://www.mooc-list.com/course/albanian-wma>

³⁸<http://risialbania.al/index/wp-content/uploads/2016/05/Annual-Brief-ALMOOC-27.pdf>

Më tej, vlen të theksohet edhe një projekt i Profesorit të Universitetit të Western Case Reserve (CWRU) Michael Goldberg i cili quhet 'Përtej Luginës Silicon' i cili ofrohet në partneritet me Ambasadën e SHBA në Maqedoninë e Veriut dhe CEFÉ Maqedoni. Goldberg nisi 'Përtej Luginës Silicon' në Coursera në prill 2014 dhe ajo ka tërhequr mbi 175,000 studentë nga 190 vende gjatë 5 viteve të fundit. Përtej Luginës Silicon është përkthyer në 16 gjuhë (shumica në platformën Coursera) përfshirë Maqedoninë.³⁹

Përveç kësaj vlen të theksohen edhe MOOC që UEJL nëpërmjet Coursera i ofron për stafin mësimdhënës si dhe studentët e UEJL. Duhet potencuar se pas mbarimit të kurseve, profesorëve dhe studentëve u jepen certifikata falas nga universitetet të cilët japin kursin falas siç janë Universiteti i Harvard, Yale, Michigan, etj.

5.2. Kush janë përdoruesit e MOOC dhe kush përfiton nga MOOC?

MOOC origjinën e kanë në një shtet anglishtfolës, pra në Kanada në vitin 2008. Këto MOOC më pas filluan të ofrohen për herë të parë nga universitete prestigjioze në SHBA si Massachusetts, California, MIT, Harvard dhe Stanford. Këto MOOC ishin në gjuhën angleze po ashtu, dhe se në shumicën e rasteve përdoruesit e MOOC ishin studentët apo të punësuarit, të cilët flasin gjuhën angleze, nëpër institucione të ndryshme në të gjitha vendet e botës.

Në kohën e fundit duke pasur parasysh faktin që ka shumë të interesuar për të ndjekur MOOC në gjuhën e tyre amtare (Meixler, 2013 dhe Pyetësori 2⁴⁰) universitetet filluan të ofrojnë MOOC në më tepër gjuhë botërore, duke përfshirë rusisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Pjesa dërmuese e këtyre MOOC ofrohen nga shtete evropiane (Meixler, 2013).

Po ashtu hulumtimi jonë teorik nxori në pah provat dhe vëzhgimet e hulumtimeve të shumë studiuesve dhe dijetarëve që merreshin me MOOC dhe përdorimin e tyre nëpër gjithë botën që dëshmojnë se MOOC ofrohen në një numër të kufizuar të gjuhëve botërore prandaj edhe shumica e përdoruesve të MOOC e njohin gjuhën angleze dhe si rezultat mund

³⁹<https://cefe.mk/en/opportunity-to-participate-in-free-moderated-beyond-silicon-valley-online-entrepreneurship-course/>

⁴⁰Shih Aneks 2 – Pyetësori 2

të ndjekin MOOC pa problem (Castillo et al., 2015; Godwin-Jones, 2014; Straton & Grace, 2016). Shah (2014) dhe Straton & Grace (2016) gjetën që diku 80% e MOOC ofroreshin në gjuhën angleze. Pos gjuhës angleze, MOOC ofroreshin edhe në 13 gjuhë të tjera botërore (Straton & Grace, 2016).

Sipas gjetjeve tona nga hulumtimi teorik, pra nga shqyrtimi i literaturës që trajtojnë MOOC mund të konkludojmë se numri i vogël i kurseve masive MOOC që ofrohen në gjuhë të ndryshme botërore të ndryshme nga gjuha angleze, pamundësojnë qasjen e gjithsecilit të interesuar për të ndjekur MOOC.

Pra, hulumtimi jonë nxjerrë në pah prova që mundësojnë të konkludojmë që MOOC nuk janë në dispozicion për çdo person që do dëshironte të ndjekë MOOC pasi ata që nuk e flasin gjuhën angleze, në fakt nuk do të përfitonin asgjë nga ndjekja e MOOC në gjuhën angleze. E ky numër i njerëzve që nuk e flasin gjuhën angleze, në veçanti në vendet në zhvillim, është i madh dhe si rrjedhojë kufizon mundësinë e përdorimit të MOOC (EF English Proficiency Index, 2015 në Straton & Grace, 2016).

Për të rritur numrin e përdoruesve, ofertuesit e MOOC kanë hartuar një alternativë e që ka të bëjë me përkthimin e ligjëratave nga gjuha angleze në gjuhën amtare të atyre përdoruesve që nuk e flasin gjuhën angleze. Kjo më tej sipas hulumtimit tonë teorik dhe praktik mund ta rritë ose veç më ka rritur numrin e përdoruesve të MOOC në botë dhe rajon.⁴¹

Edhe pyetësori ynë i dytë më sipër, në pyetjen e 8 i cili ka të bëjë me përshtatshmërinë e kurseve MOOC në gjuhën amtare, nxori në pah se studentët që i kishim anketuar në një përqindje të konsiderueshme preferojnë kurse të përkthyer në gjuhën amtare. Kjo zakonisht ndodh me studentë që nuk e njohin mirë gjuhën angleze dhe gjuha amtare në këtë rast u ndihmon për të kuptuar mësimet më mirë edhe pse kjo në të shumtën e rasteve varet edhe nga përkthimi nëse është cilësor apo jo. Po ashtu edhe përgjigjet e studentëve në pyetjen numër 10 përdëfton faktin që studentët kanë nevojë t'iu përkthehen ligjëratat me qëllim të përvetësimit sa më të mirë të ligjëratave.

⁴¹Shih Aneks 2 – Pyetësori 2

Sa i përket përfituesve nga MOOC, sipas hulumtimit tonë përfitues të MOOC janë studentët që ndjekin lëndë që zakonisht nuk mund t'i gjejnë në universitetet që ata ndjekin studimet. Po ashtu përfitues janë edhe të punësuarit në institucione të ndryshme si arsimore po ashtu të biznesit që ndjekin MOOC për zhvillim profesional.

5.3. A e rrit MOOC interesimin dhe mundësinë për arsim gjatë gjithë jetës?

MOOC rrisin interesimin dhe mundësinë për arsim gjatë gjithë jetës. MOOC janë konsideruar nga shumë institucione arsimore në Unionin Evropian si një mënyrë fleksibile për të siguruar mësim gjatë gjithë jetës, e cila përputhet me faktin se ata që synojnë të ofrojnë MOOC për studentë të moshuar janë diku 80% të institucioneve (Gaebel, 2021 dhe Pyetësi 1).⁴²

5.4. Cila është mënyra më efektive e përdorimit të MOOC?

Sipas hulumtimit teorik për të pasur një përdorim më efikas të MOOC dhe për të siguruar përfitime akademike dhe profesionale për ata që vendosin të ndjekin kurse masive të hapura MOOC, universitetet duhet të rimodelojnë strukturat dhe praktikën më të mira të përdorimit të teknologjisë informative për të ofruar MOOC cilësor. Sipas një udhëheqësi të një projekti të quajtur 'E ardhmja Dixhitale e Arsimit' i cili njëkohësisht është edhe profesor i sociologjisë pranë Universitetit Stanford, Mitchell Stevens, universitetet e kalibrit të Universitetit të Stanfordit duhet të integrojnë dhe futin të mësuarit dixhital dhe teknologjinë më të re në strukturën universitare (Waldrop, 2013; Alhazzani, N, 2020).

Më pas sipas përgjigjeve nga anketa e bërë me studentë nëpërmjet pyetësit 2 rreth 82% e studentëve mësojnë më mirë nëpërmjet videove dhe këto përgjigje dëshmojnë se MOOC, duke qenë që përmbajnë ligjëratat të xhiruara në video, janë shumë efektive dhe ndihmojnë studentët të kenë rezultate më të mira në të nxënit.

⁴²Shih Aneks 1 – Pyetësi 1

Ndërsa, sa i përket mënyrës së të mësuarit në përgjithësi, sipas anketës së bërë me studentët nëpërmjet Pyetësorit 2⁴³ është nëpërmjet 'face to face' ligjëratave, ndërsa sa i përket atyre online studentët preferojnë ligjëratat të jenë në gjuhën amtare ose nëse është ndonjë kurs ndërkombëtar atëherë mënyra më e mirë është nëpërmjet përkthimit të ligjëratave.

5.5. Çfarë ndikon në përvetësimin e përmbajtjeve gjatë ndjekjes së ligjëratave në MOOC?

Duke pasur parasysh faktin që MOOC ofrohen në shumicën e rasteve në gjuhën angleze për shkak të origjinës së tyre që vijnë nga shtete anglishtfolëse, vetëm ata që njohin gjuhën angleze kishin mundësi të ndjekin MOOC. Pra, numri i atyre që ndiqnin MOOC nuk ishte edhe aq i madh derisa nuk filluan MOOC të përkthehen në gjuhën amtare të studentëve apo të atyre që ishin të interesuar të ndiqnin MOOC. Nga kjo mund të konkludojmë se gjuha në të cilën ofrohen MOOC si dhe përkthimi nga gjuha angleze në gjuhën amtare të kandidatëve janë faktorë shumë të rëndësishëm që ndikojnë në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore nëpërmjet MOOC (Shah, 2014; Godwin-Jones, 2014; Castillo et al., 2015; Straton & Grace, 2016 & Pyetësori 2).⁴⁴

5.6. Cili është perceptimi i palëve të interesit për MOOC?

Siç vërejtëm në shqyrtimin e literaturës si dhe nga anketa që bëmë me studentët e Fakultetit të CST⁴⁵ në UEJL Tetovë, nëpërmjet pyetësorëve, MOOC po konsiderohen si mundësi për të gjithë ata që duan të aftësohen apo të specializohen për lëndë të caktuara si dhe për zhvillim profesional dhe arsimim të mëtejshëm. Më tej, shqyrtimi i literaturës nxori në pah faktin që MOOC konsiderohen si kurse cilësore që ofrohen nga ekspertë cilësorë nga universitetet prestigjioze botërore si dhe që janë kurse falas në shumicën e rasteve dhe ofrojnë mësimdhënie dhe nxënie fleksibile (Gaebel, 2021).

⁴³Shih Aneks 2

⁴⁴Shih Aneks 2

⁴⁵Shih Aneks 1 dhe 2

Sidoqoftë, perceptimi i të gjitha palëve të interesit në arsim, në veçanti të atij sipëror për MOOC është shumë pozitiv dhe inkurajon për ndjekje të kurseve masive MOOC për arsimim gjatë gjithë jetës, ndonjë specializim apo edhe për zhvillim profesional (Marguerite, 2012).

5.7. Analiza e hipotezave

5.7.1. Hipoteza 1

- **MOOC rrisin mundësinë dhe interesimin për arsimim dhe zhvillim profesional gjatë gjithë jetës.**

Gjetjet nga hulumtimi teorik dhe praktik sigurojnë të dhëna të mjaftueshme që përdëtojnë hipotezën e parë të këtij punimi magjistrature. Në shumë institucione arsimore të shumë shteteve të Unionit Evropian MOOC konsiderohen si kurse online të cilat mundësojnë mësimdhënie dhe nxënie fleksibile që siguron mësim gjatë gjithë jetës. Rreth 80% e institucioneve të vëzhguara kanë pohuar se kurset ndiqen nga studentë të moshuar ose të punësuar nëpër institucione arsimore apo biznesi. Të dhënat që nxorëm nga anketa me studentët e UEJL po ashtu përdëfton hipotezën se MOOC sigurojnë aftësim të studentëve dhe mësim gjatë gjithë jetës (Gaebel, 2021; Marguerite, 2012 dhe Pyetësi 1).⁴⁶

5.7.2. Hipoteza 2

- **Me anë të MOOC mësohet më lehtë dhe më shpejt sesa në klasë.**

Gjetjet nga hulumtimi teorik dhe praktik i këtij punimi të magjistraturës pjesërisht provuan hipotezën e dytë. MOOC pa dilema janë vlerë e shtuar e arsimit në përgjithësi. MOOC sigurojnë arsim cilësor duke u mundësuar kandidatëve të përvetësojnë dije dhe shkathtësi që me siguri nuk do t'i hasnin apo nuk do t'i gjenin në vendet ku ata jetojnë dhe me siguri jo në formatin që mund ta gjejnë në platformat që ofrojnë MOOC. Si pasojë, universitetet synojnë të tërheqin dhe kontribuojnë në ndërgjegjësimin, përvojën dhe aspiratat ndërkombëtare të studentëve dhe të profesorëve dhe të zhvillojnë një kurrikulë të

⁴⁶Shih Aneks 1 – Pyetësi 1

ndërkombëtarizuar. Që do të thotë se, përhapja e MOOC në botë paraqet një potencial ndryshimi në botën e arsimit në veçanti atij të lartë (Marguerite, 2012). Sidoqoftë, edhe përkundër cilësisë që ofrojnë MOOC Marguerite (2012) konstaton se MOOC nuk do të mund të zëvendësojë kolegjet dhe universitetet, por ato do të plotësojnë arsimin e lartë tradicional (Marguerite, 2012). Nga ana tjetër edhe gjetjet nga hulumtimi ynë nuk mbështesin hipotezën 2, pasi studentët në shumicë janë deklaruar që mësimi në klasë është më efikas dhe se ata do të preferonin mësimin në klasë para atij online (Pyetësi 2).⁴⁷

5.7.3. Hipoteza 3

➤ **Gjuha në të cilën ofrohet një MOOCs ndikon në përvetësimin e përmbajtjeve.**

Gjetjet nga hulumtimi teoriko praktik i këtij punimi të magjistraturës siguruan prova të mjaftueshme për të përdëftuar hipotezën 3. Duke pasur parasysh faktin që MOOC ofrohen në shumicën e rasteve në gjuhën angleze për shkak të origjinës së tyre që vijnë nga shtete anglishtfolëse vetëm ata që njohin gjuhën angleze kishin mundësi të ndjekin MOOC. Pra, numri i atyre që ndiqnin MOOC nuk ishte edhe aq i madh derisa nuk filluan MOOC të përkthehen në gjuhën amtare të studentëve apo të atyre që ishin të interesuar të ndiqnin MOOC. Nga kjo mund të konkludojmë se gjuha në të cilën ofrohen MOOC si dhe përkthimi nga gjuha angleze në gjuhën amtare të kandidatëve janë faktorë shumë të rëndësishëm që ndikojnë në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore nëpërmjet MOOC (Shah, 2014; Godwin-Jones, 2014; Castillo et al., 2015; Straton & Grace, 2016 & Pyetësi 2⁴⁸).

⁴⁷Shih shtojcën 2

⁴⁸Shih shtojcën 2

6. KONKLUDIMI

6.1. Kontributi i punimit

MOOC-sat për rajonin tonë janë risi, ky studim ka rëndësi sepse është ndër të parët që analizon përdorimin e tyre si dhe përfshin adaptim të titrave dhe studim krahasues për mësimin me titra në gjuhë lokale (në këtë rast gjuhë shqipe). Materialet pastaj janë ndarë me studentë që e mësojnë këtë lëndë apo lëndët tjera që të analizohet ndikimi i gjuhës së MOOC-ave në përvetësimin dhe pranimin e këtij formati të hapur të materialeve mësimore në vende ku gjuha angleze nuk është gjuha e parë. MOOC-sat do të jenë e ardhmja e arsimit, duke përfshirë botën dhe rajonin.

6.2. Kufizimet e punimit

Punimi i magistraturës, gjegjësisht hulumtimi praktik për qëllime të këtij punimi, ka kufizimet e tij të vogla. Kufizimi i parë është numri i vogël i studentëve që morën pjesë në këtë hulumtim, që në fakt përfaqësojnë një madhësi të vogël të mostrës që morën pjesë në anketën e bërë nëpërmjet instrumentit hulumtues -pyetësor. Kjo mund të rezultojë në një margjinë relativisht të madhe të gabimit. Për më tepër, studimi u përqendrua vetëm në disa pyetje me përzgjedhje të përgjigjes, e jo edhe në pyetje të hapura, pra me tekst që do të siguronin gjetje më të detajuara.

6.2. Rekomandimet

Nga hulumtimi teoriko-praktik që bëmë për këtë punim të magistraturës, që nxori në pah gjetje interesante, mund të nxjerrim disa rekomandime:

- Rekomandohet që të kryhen hulumtime të thelluara që do të përfshinin më tepër palë të interesit, siç janë profesorë universitarë, persona të biznesit, persona të moshuar, studentë, nxënës etj. gjatë së cilit hulumtim do të dilnin të dhëna më të besueshme sa i përket perceptcionit të tyre për MOOC dhe ndikimit të tyre në sfera të

ndryshme të jetës përfshirë edhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Gjetjet po ashtu do provonin edhe vlefshmërinë e gjetjeve aktuale që kemi nxjerrë në pah në këtë punim magjistrature;

- Rekomandohet që të bëhen përkthime të MOOC nga universitetet më të njohura në botë siç janë Harvard, MIT, Stanford, Yale etj. në gjuhët lokale që të mundën sa më tepër të interesuar të ndjekin MOOC;
- Rekomandohet që sa më shumë mësime të bëhen në bashkëpunim me specialistë të teknologjisë informative të krijojnë MOOC të tyre duke marrë për model MOOC që ofrohen nga universitetet më prestigjioze botërore.

BIBLIOGRAFIA

- Abelson, Hal (2008), 'The Creation of OpenCourseWare at MIT', Journal of Science Education and Technology, Vol. 17, No. 2, April 2008 (© 2007), DOI: 10.1007/S10956-007-9060-8, p. 164-165
<https://www.jstor.org/stable/pdf/41219407.pdf?refreqid=excelsior%3A6ee1ad42d9c5ea699c72b8ce938c38d7>
- Agudo, Roberto Rey (2019), 'The Language of MOOCs', Can providers of massive open online courses achieve their goal of educating the most possible people when their offerings are overwhelmingly in English? Roberto Rey Agudo is language program director in the department of Spanish and Portuguese at Dartmouth College and a 2018 Public Voices Fellow with The Op-Ed Project. January 9, 2019,
<https://www.insidehighered.com/digital-learning/views/2019/01/09/moocs-overwhelming-dependence-english-limits-their-impact-opinion>
- Alhazzani, Noura (2020), 'MOOCs impact on higher education', Volume 2, Issue 1, 2020, 100030, Social Sciences & Humanities Open,
<https://doi.org/10.1016/j.ssaho.2020.100030>,
<https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S259029112030019X>
- Alario-Hoyos C., Pérez-Sanagustín M., Cormier D., Delgado-Kloos C., (2013), 'Proposal for a Conceptual Framework for Educators to Describe and Design MOOCs', Journal of Universal Computer Science, vol. 20, no. 1 (2014), 6-23, submitted: 9/6/13, accepted: 30/9/13, appeared: 1/1/14 © J.UCS,
https://www.researchgate.net/publication/265915730_Proposal_for_a_Conceptual_Framework_for_Educators_to_Describe_and_Design_MOOCs
- ALBRIGHT, P., (2005) 'OPEN EDUCATIONAL RESOURCES OPEN CONTENT FOR HIGHER EDUCATION' Final forum report - 24 October – 2 December 2005, International Institute for Educational Planning, INTERNET DISCUSSION FORUM, WESTERN INTERSTATE COMMISSION FOR HIGHER EDUCATION, COLORADO, USA,
<https://docs.iiep.unesco.org/I009621.pdf>

- AlDahdouh, Alaa A. & Osório, António J., (2016), 'PLANNING TO DESIGN MOOC? THINK FIRST!', The Online Journal of Distance Education and e-Learning, April 2016 Volume 4, Issue 2, <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED572897.pdf>
- Alhazzani, Noura (2020), 'MOOCs impact on higher education', King Saud University, Riyadh, Saudi Arabia, Social Sciences & Humanities OpenVolume 2, Issue 1, 2020
<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC7265837/>
- Bartolomé-Pina, A. R., & Steffens, K. (2015). Are MOOCs promising learning environments? *Communicar*, 22(44), 91-99.
- Bozkurt, A., Akgün-Özbek, E., & Zawacki-Richter, O. (2017). Trends and patterns in massive open online courses: Review and content analysis of research on MOOCs (2008-2015). *The International Review of Research in Open and Distributed Learning*, 18(5), 118-147. doi: 10.19173/irrodl.v18i5.3080
- Bozkurt, A., Kilgore, W., & Crosslin, M. (2018). Bot-teachers in hybrid massive open online courses (MOOCs): A post-humanist experience. *Australasian Journal of Educational Technology*, 34(3), 39-59.
- Bozkurt, A., Özdamar Keskin, N., & de Waard, I. (2016). Research trends in massive open online course (MOOC) theses and dissertations: Surfing the tsunami wave. *Open Praxis*, 8(3), 203-221.
- Bulfin, S., Pangrazio, L., & Selwyn, N. (2014). Making MOOCs: The construction of a new digital higher education within news media discourse. *The International Review of Research in Open and Distributed Learning*, 15(5), 291-305. doi: 10.19173/irrodl.v15i5.1856
- Calonge, D., & Shah, M. (2016). MOOCs, graduate skills gaps, and employability: A qualitative systematic review of the literature. *The International Review of Research in Open and Distributed Learning*, 17(5), 67-90. doi: 10.19173/irrodl.v17i5.2675
- Chen, Y. (2014). Investigating MOOCs through blog mining. *The International Review of Research in Open and Distributed Learning*, 15(2), 85-106. doi: 10.19173/irrodl.v15i2.1695

- Chen W & Jia J. (2016), 'Comparison of Online and Onsite Students' Learning Outcomes and Experiences in a Massively Open Online Course in China' September 2016 Journal of Educational Technology Development and Exchange 9(1) DOI:10.18785/jetde.0901.05 Project: Massively Open Online Course, [https://www.researchgate.net/publication/312490582_Comparison_of_Online_and_Onsite_Students' Learning Outcomes and Experiences in a Massively Open Online Course in China](https://www.researchgate.net/publication/312490582_Comparison_of_Online_and_Onsite_Students'_Learning_Outcomes_and_Experiences_in_a_Massively_Open_Online_Course_in_China)
- Conole, G. (2008). New schemas for mapping pedagogies and technologies. Ariadne, (56). <http://www.ariadne.ac.uk/issue/56/conole/>
- Conole, G. (2010). An overview of design representations. In Proceedings of the 7th International Conference of Networked Learning (NLC2010) (pp. 482-489). Denmark: Aalborg. <https://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.463.2356&rep=rep1&type=pdf>
- Conole, Gráinne (2013), 'MOOCs as disruptive technologies: strategies for enhancing the learner experience and quality of MOOCs', University of Leicester grainne.conole@le.ac.uk, RED - Revista de Educación a Distancia. Número 39 <http://www.um.es/ead/red/39>
- Cormier, D. (2010, December 8). What is a MOOC? [Video file]. Retrieved from <https://www.youtube.com/watch?v=eW3gMGqcZQc>
- Cretchley, J., Rooney, D., & Galois, C. (2010). Mapping a 40-Year history with leximancer: Themes and concepts in the Journal of Cross-Cultural Psychology. Journal of Cross-Cultural Psychology, 41(3), 318-328.
- Dalsgaard, C., & Paulsen, M. F. (2009). Transparency in Cooperative Online Education. *The International Review of Research in Open and Distributed Learning*, 10(3). <https://doi.org/10.19173/irrodl.v10i3.671>, <http://www.irrodl.org/index.php/irrodl/article/view/671>

- Dalsgaard Christian & Thestrup Klaus (2015), 'Dimensions of Openness: Beyond the Course as an Open Format in Online Education', Centre for Teaching Development and Digital Media, Aarhus University, Denmark, International Review of Research in Open and Distributed Learning Volume 16, Number 6, November – 2015
<https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1084370.pdf>
- Deimann, M. (2015). The dark side of the MOOC: A critical inquiry on their claims and realities. Current Issues in Emerging eLearning, 2(1), 3.
- Diaz, V., Brown, M., & Pelletier, S. (2013). Learning and the massive open online course: A report on the ELI focus session [PDF file]. Retrieved from
<https://net.educause.edu/ir/library/pdf/ELI3029.pdf>
- Dodson, M. N., Kitburi, K., & Berge, Z. L. (2015). Possibilities for MOOCs in corporate training and development. Performance Improvement, 54(10), 14-21. doi: 10.1002/pfi.21532
- Downes, S. (2012). Connectivism and connective knowledge: Essays on meaning and learning networks [PDF file]. National Research Council Canada. Retrieved from
http://www.downes.ca/files/books/Connective_Knowledge-19May2012.pdf
- Duke Betsy, Harper Ginger and Johnston Mark (2013), 'Connectivism as a Digital Age Learning Theory', The International HETL Review, Special Issue, 2013 Kaplan University, USA,
<https://www.hetl.org/wp-content/uploads/2013/09/HETLReview2013SpecialIssueArticle1.pdf>
- Friesen, N., (2009), 'Open Educational Resources: New Possibilities for Change and Sustainability', International Review of Research in Open and Distance Learning Volume 10, Number 5. ISSN: 1492-3831 November–2009, Thomson Rivers University, Canada
- Gaebel M., (2014), "MOOC: Massive Open Online Courses – January 2014", EUA Occasional Papers. <https://www.igniteengineers.com/mooc-advantages-and-disadvantages/>
- Gaebel, M., Zhang, T., Stoeber, H. & Morrisroe, A. (2021). Digitally enhanced learning and

- teaching in European higher education institutions. European University Association
absl. <https://eua.eu/downloads/publications/digihe%20survey%20report.pdf>
- Gough, D., Oliver, S., & Thomas, J. (Eds.). (2012). *An introduction to systematic reviews*.
London; Thousand Oaks, Calif: SAGE.
- Hylan, Jan (2006), 'Open educational resources: Opportunities and challenges', *Proceedings
of Open Education*,
https://www.researchgate.net/publication/235984502_Open_educational_resources_Opportunities_and_challenges
- Inamorato dos Santos, A., Punie, Y., Castaño-Muñoz, J. (2016) *Opening up Education: a
Support Framework for Higher Education Institutions*. JRC Science for Policy Report,
EUR27938EN; doi:10.279.1/293408
<https://ec.europa.eu/jrc/en/open-education/framework-guidelines>
- Ingolfssdottir K. (2014), "Impact of MOOCs and Other Forms of Online Education [Point of
View], "in *Proceedings of the IEEE*, vol. 102, no. 11, pp. 1639-1643, Nov. 2014, doi:
10.1109/JPROC.2014.2360025. <https://ieeexplore.ieee.org/stamp/stamp.jsp?arnumber=6926925>
- Karnouskos, S., Holmlund M. (2014), 'Impact of Massive Open Online Courses (MOOCs) on
Employee Competencies and Innovation', *Blekinge Institute of Technology School of
Management Master of Business Administration (MBA)*, May, 2014,
<http://www.diva-portal.org/smash/get/diva2:832165/FULLTEXT01.pdf>
- Liyanagunawardena, T., Adams, A., & Williams, S. (2013). *MOOCs: A systematic study of the
published literature 2008-2012*. *The International Review of Research in Open and
Distributed Learning*, 14(3), 202-227. doi: 10.19173/irrodl.v14i3.1455
- Ledwon, Heba (2020), *10 Most Cited Research Papers on MOOCs* , To get an overview of the
topics and trends in the research on MOOCs, Class Central has created a list of the
most cited research papers on MOOCs, Aug 4th, 2020
<https://www.classcentral.com/report/most-cited-mooc-research/>
- Marguerite, Dennis (2012), 'The Impact of MOOCs on Higher Education', *College and*

University, v88 n2 p24-30 Fall 2012, American Association of Collegiate Registrars and Admissions Officers (AACRAO). One Dupont Circle NW Suite 520, Washington, DC 20036. Tel: 202-293-9161; Fax: 202-872-8857; e-mail: pubs@aacrao.org; Web site: <http://www.aacrao.org/>, <https://eric.ed.gov/?id=EJ995763>

MarketDigits (2021), 'Massive Open Online Courses (MOOCs) Market Growing at a CAGR of 32.8% during 2021-2026, Growing Popularity, Booming Segments, Emerging Trends and Investors Seeking Growth, Top Players: Coursera, edX, Intellipaat, Udemy, LinkedIn, Simplilearn, January 06, 2021 14:01 ET | Source: © 2021 GlobeNewswire, Inc. All Rights Reserved.

Markoff, John (2011), 'Armies of Expensive Lawyers, Replaced by Cheaper Software',

SMARTER THAN YOU THINK, March 4, 2011,
<https://www.nytimes.com/2011/03/05/science/05legal.html>

McAuley, A., Stewart B., Siemens G. and Cormier D. (2010), 'THE MOOC MODEL FOR

DIGITAL PRACTICE', MASSIVE OPEN ONLINE COURSES, Digital ways of knowing and learning, MASSIVE OPEN ONLINE COURSES, Digital ways of knowing and learning Created through funding received by the University of Prince Edward Island through the Social Sciences and Humanities Research Council's "Knowledge Synthesis Grants on the Digital Economy " . 2010 CC Attribution. http://davecormier.com/edblog/wp-content/uploads/MOOC_Final.pdf

Meixler, Anna, Stiegler, Hans and Dewitz, Holger (2013), 'MOOCs in Europe', Iversity, 2

August 2013, <https://iversity.org/blog/english-moocs-in-europe/>

Mehta, Neha (2020), ONLINE COURSES (MOOC), What Is MOOC-Based Learning?

Various kinds of eLearning courses are in vogue these days. MOOCs are one of them.

<https://elearningindustry.com/mooc-based-learning-advantages-and-disadvantages>

Perryman, Dr Leigh-Anne, (Evaluating long-term MOOC impact: a case study of TEL MOOC',

Conference Proceedings & Working Papers Pan-Commonwealth Forum 9 (PCF9), 2019, The Open University, UK, <http://oasis.col.org/handle/11599/3347>

Rollins, Amanda (2018), '6 Steps To Creating A MOOC Or A COOC', CORPORATE ELEARNING, September 12, 2018, <https://elearningindustry.com/creating-a-mooc-cooc-6-steps>

Ruipérez-Valiente, J. A., Martín, S., Reich, J., Castro, M., (2020), 'The UnMOOCing Process:

Extending the Impact of MOOC Educational Resources as OERs', Department of Information and Communication Engineering, University of Murcia (UMU), 30008 Murcia, Spain 2 Teaching Systems Lab, Massachusetts Institute of Technology (MIT), Cambridge, MA 02139, USA; jreich@mit.edu 3 Department of Electrical and Computer Engineering, Universidad Nacional de Educación a Distancia (UNED), 28040 Madrid, Spain; smartin@ieec.uned.es (S.M.); mcastro@ieec.uned.es (M.C.) * Correspondence: jruiperez@um.es; Tel.: +34-868-887-865 Received: 21 July 2020; Accepted: 3 September 2020; Published: 8 September 2020

Sustainability 2020, 12, 7346; doi:10.3390/su12187346

www.mdpi.com/journal/sustainability

<file:///C:/Users/Rushit/Downloads/sustainability-12-07346.pdf>

Salamah, U.G., Helmi, R.A.A. (2018), 'MOOC Platforms: a Review and Comparison', Research paper, International Journal of Engineering & Technology, 7 (4.11) (2018) 70-74 International Journal of Engineering & Technology Website:

www.sciencepubco.com/index.php/IJET,

<https://www.sciencepubco.com/index.php/ijet/article/view/20690>

Salisbury, A. D., (2014), 'Impacts of MOOCs on Higher Education', October 27, 2014 | edX

team, <https://blog.edx.org/impacts-moocs-higher-education>

Social Sciences & Humanities Open journal homepage:

www.elsevier.com/locate/ssaho,

<https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S259029112030019X>

Siemens, G. (2006). Knowing knowledge. KnowingKnowledge.com Electronic book.

www.knowingknowledge.com. [viewed 21/ 04/ 2021)

<https://issuu.com/johoedu/docs/siemens--2006--knowingknowledge>

Srikanth, M., (2020), 'The Advantages and Disadvantages of MOOCs for Learning', Custom eLearning, Instructional Design, July 7, 2020

<https://www.infoprolearning.com/blog/advantages-and-disadvantages-of-moocs-massive-open-online-courses-for-learning/>

Stratton, Caroline & Grace, Rob (2016), 'Exploring Linguistic Diversity of MOOCs:

Implications for International Development', wrg123@ist.psu.edu, ASIST 2016, October 14-18, 2016, Copenhagen, Denmark.

<https://asistdl.onlinelibrary.wiley.com/doi/pdf/10.1002/pa2.2016.14505301071>

Tsironis, A., Katsanos, Ch., Xenos, M. (2016), 'Comparative usability evaluation of three

popular MOOC platforms', Conference Paper · April 2016, School of Science and Technology, Hellenic Open University, Patras, Greece, Business Administration Department, Technological Educational Institute of Western Greece, Patras, Greece, All content following this page was uploaded by Alexandros Tsironis on 06 October 2017. [\(PDF\) Comparative usability evaluation of three popular MOOC platforms \(researchgate.net\)](#)

TOWARDS A NEW PEDAGOGY, FIVE WAYS MOOCs ARE INFLUENCING TEACHING AND

LEARNING, March 2016 contactnorth.ca,

https://teachonline.ca/sites/default/files/tools-trends/downloads/five_ways_moocs_are_influencing_teaching.pdf

Waldrop, M. Mitchell, (2013), 'Massive Open Online Courses, aka MOOCs, Transform Higher Education and Science', Science engineering and technology courses have been in the vanguard of the massive open online course movement. These classes also are providing fodder for scientific research on learning, Nature magazine on March 13, 2013,

<https://www.scientificamerican.com/article/massive-open-online-courses-transform-higher-education-and-science/>

Windle, R. J., Wharrad, H., McCormick, D., Lavery, H., and Taylor, M., (2010). Sharing and

reuse in OER: experiences gained from open reusable learning objects in health. Journal of Interactive Media in Education [online]. 2010 (01). Available: <http://jime.open.ac.uk/jime/article/viewArticle/2010-4/html>

Yazdanian R., West R., Dillenbourg, P. (2020), 'Keeping Up with the Trends: Analyzing the Dynamics of Online Learning and Hiring Platforms in the Software Programming', <https://doi.org/10.1007/s40593-020-00231-1>, <https://link.springer.com/article/10.1007/s40593-020-00231-1>

Yousef, A.M.F., Schroeder, U., Wosnitza, M., Jakobs, H., (2014), 'MOOCs a review of the state-of-the-art', <https://www.researchgate.net/publication/275823066>, Chapter January 2014, <file:///C:/Users/r.emini/Downloads/MOOC.pdf>

Yousef, A. M. F., Chatti, M. A., Schroeder, U., and Wosnitza M. (2015), 'A Usability Evaluation of a Blended MOOC Environment: An Experimental Case Study', 1RWTH Aachen University, Germany, 2Fayoum University, Egypt, April, 2015 <http://www.irrodl.org/index.php/irrodl/article/view/2032/3270>

SHTOJCAT

Pyetësi 1: MOOC-at dhe përdorimi i tyre në edukim

1. A keni dëgjuar për MOOC-at (Massive Open Online Course)?
2. Nëse keni dëgjuar, si do t'i vlerësoni MOOC-at?
3. MOOC-at e rrisin mundësinë dhe interesin për edukim gjatë gjithë jetës.
4. MOOC-at më tepër përdoren për edukim joformal sesa në shkollim formal.
5. A keni mësuar ndonjëherë prej kurseve masive të hapura online (MOOC)?

Pyetësi 2: Përpunim i titrave të lëndës Python në Udacity

1. Dëshironi të mësoni mësimet përmes videove?
2. Tutorialet online janë më të përshtatshme për mësim joformal sesa për mësim formal?
3. Sipas jush, mënyra më e lehtë e të mësuarit është?
4. Mënyra më e përshtatshme e të mësuarit është përmes mëimit (Kurseve Online).
5. Mësimi (Kurset Online) me përkthim të përshtatur në gjuhën tuaj amtare është shumë më i kuptueshëm.
6. Mënyra më e përshtatshme e të mësuarit është face to face?
7. Tutortialet me titra të përkthyer në gjuhën shqipe ndihmojnë shumë në përvetësimin e temës së prezantuar.